



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria

Vlada-Government

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

NJPMNP/JPNJP/PMUPE

Raporti Vjetor 2011

Performanca e Ndërmarrjeve Publike Qëndrore

2012

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	5
1. Parathënie	6
2. Qeverisja Korporative.....	7
2.1 Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.....	7
2.2 Korniza Ligjore	9
2.3 Konflikti i interesit	11
2.4 Dividenda	12
2.5 Subvencionet	12
2.6 Përfshirja e sektorit privat dhe ristrukturimi i Ndërmarrjeve Publike.....	12
2.7 Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike.....	14
2.7.1 Bordi i Drejtorëve	14
2.7.2 Menaxhmenti	16
2.7.3 Raportimet.....	16
3 Ndërmarrjet Publike	19
3.1 Sektorët e Ndërmarrjeve Publike	19
3.2 Politikat Zhvillimore, Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Ndërmarrjeve Publike	20
3.3 Përkrahja Financiare nga Qeveria	21
3.4 Performanca Financiare e NP-ve.....	22
3.5 Performanca Operative e Sektorëve.....	23
3.6 Numri i punëtorëve të NP.....	25
4 Performanca individuale e Ndërmarrjeve Publike Qendrore	26
4.1 KEK.....	26
4.2 KOSTT	30
4.3 PTK	35
4.4 ANP.....	39
4.5 Hekurudhat e Kosovës	42
4.6 Hekurudhat e Kosovës – Infrakos	46
4.7 Trainkos.....	49
4.8 KRU Prishtina	52
4.9 KRU Radoniqi.....	56
4.11 KRU Hidroregjioni Jugor.....	64

4.12 KRU Hidrodriini.....	68
4.13 KRU Mitrovica.....	72
4.14 KU Radoniqi – Dukagjini	76
4.15 KU Drini i Bardhë.....	79
4.16 HS Ibër - Lepenci	82
4.17 KMDK.....	86
Përmbledhje dhe Rekomandime	90
Referencat:	92

Përmbledhja e Tabelave

Tabela 1 - Raportimet në bazë të ligjit mbi NP	16
Tabela 2- Mjetet e ndara nga Qeveria për NP.....	21
Tabela 3 - Performanca Financiare e NP bazuar në raportet e auditorit të jashtëm.....	22
Tabela 4 - Performanca Operative e Sektorit të Energjisë.....	23
Tabela 5 - Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit-PTK.....	23
Tabela 6 - Performanca Operative e Sektorit të Ujit.....	24
Tabela 7 - Numri i Punëtorëve në NP.....	25
Tabela 8 - Të dhënat e përgjithshme të KEK-ut	26
Tabela 9 - Performanca Operative e KEK-ut.....	28
Tabela 10 - Performanca Financiare e KEK-ut.....	29
Tabela 11 - Të dhënat e përgjithshme të KOSST-it.....	30
Tabela 12- Performanca Operative e KOSTT-it.....	33
Tabela 13 -Performanca Financiare e KOSTT-it.....	33
Tabela 14 - Të dhënat e përgjithshme të PTK-ës.....	35
Tabela 15 - Performanca Operative e PTK.....	38
Tabela 16 - Performanca Financiare e PTK.....	38
Tabela 17 - Të dhënat e përgjithshme të ANP-ës	39
Tabela 18 - Performanca Financiare e ANP	41
Tabela 19 - Të dhënat e përgjithshme të HK	42
Tabela 20 - Performanca Operative e HK.....	45
Tabela 21 - Performanca Financiare e HK	45
Tabela 22 - Të dhënat e përgjithshme të Infracos-it.....	46
Tabela 23 - Performanca Financiare e Infracos-it	48
Tabela 24 - Të dhënat e përgjithshme të Trainkos-it	49
Tabela 25 - Performanca Operative e Trainkos-it.....	51
Tabela 26 - Performanca Financiare e Trainkos-it	51
Tabela 27 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Prishtina	52
Tabela 28 - Performanca Operative e KRU Prishtina.....	54

Tabela 29 - Performanca Financiare e KRU Prishtina.....	55
Tabela 30 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Radoniqi.....	56
Tabela 31 - Performanca Operative e KRU Radoniqi	58
Tabela 32 - Performanca Financiare e KRU Radoniqi	59
Tabela 33 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidromorava	60
Tabela 34 - Performanca Operative e KRU Hidromorava.....	62
Tabela 35 - Performanca Financiare e KRU Hidromorava	62
Tabela 36 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidroregjioni Jugor.....	64
Tabela 37 - Performanca Operative e KRU Hidroregjioni Jugor	66
Tabela 38 - Performanca Financiare e KRU Hidroregjioni Jugor	66
Tabela 39 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidrodrini.....	68
Tabela 40 - Performanca Operative e KRU Hidrodrini	70
Tabela 41 - Performanca Financiare e KRU Hidrodrini	70
Tabela 42 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Mitrovica.....	72
Tabela 43 - Performanca Operative e KRU Mitrovica	74
Tabela 44 - Performanca Financiare e KRU Mitrovica	74
Tabela 45 - Të dhënat e përgjithshme të KU Radoniqi - Dukagjini	76
Tabela 46 - Performanca Operative e KU Radoniqi - Dukagjini.....	78
Tabela 47 - Performanca Financiare e KU Radoniqi - Dukagjini	78
Tabela 48 - Të dhënat e përgjithshme të KU Drini i Bardhë	79
Tabela 49 - Performanca Operative e KU Drini i Bardhë	80
Tabela 50 - Performanca Financiare e KU Drini i Bardhë	81
Tabela 51 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Ibër - Lepenc.....	82
Tabela 52 - Performanca Operative e KRU Ibër – Lepenc.....	85
Tabela 53 - Performanca Financiare e KRU Ibër- Lepenc	85
Tabela 54 - Të dhënat e përgjithshme të KMDK.....	86
Tabela 55 - Performanca Operative e KMDK	88
Tabela 56 - Performanca Financiare e KMDK.....	88

Përmbledhja e Figurave

Figure 1 – Struktura Organizative e NJPMNP	8
Figure 2 – Administrimi i NP	20

Lista e Shkurtesave

AB	Auditori i Brendshëm
AJ	Auditori i Jashtëm
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kulla Ajrore
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
BB	Banka Botërore
BD	Bordi i Drejtorëve
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
HK	Hekurudhat e Kosovës
HS	Hidro Sistemi (Ibel-Lepenc)
ICAO	Zyra Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IFC	International Finance Corporation
KA	Komisioni i Auditimit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetësimit
KU	Kompania e Ujitjes
LNP	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
NJB	Njësi Biznesi
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
NJO	Njësia Operative
OST (KOSTT)	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
PB	Plani i Biznesit
PF	Pasqyrat Financiare
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SWOT	Fortësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet/Rreziqet
TiK	Telekomi i Kosovës
UD	Ushtrues Detyre
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

1. Parathënie

Përmirësimi i sistemit të qeverisjes korporative dhe transparencës në ndërmarrjet publike, rritja e nivelit të shërbimeve publike, përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe ngritja e transparencës në ndërmarrje publike në Kosovë, konsiderohen segmente të rëndësishme për të ofruar shërbime cilësore për të gjithë qytetarët në vend.

Më 13 Qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike. Interesat pronësore të Republikës së Kosovës, të popullit të Kosovës, në një ndërmarrje publike përfaqësohen nga aksionet dhe monitorohen nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Kjo njësi është ruajtëse e certifikatave fizike që i përfaqësojnë ato aksione. Siç nënkuptohet nga vet emri, një “ndërmarrje publike” është ndërmarrje komerciale në pronësi të publikut, që do të thotë në pronësi të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ligji për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 8, i kërkon Qeverisë të raportojë në baza vjetore në Kuvend mbi performancën e Ndërmarrjeve Publike dhe ky është raporti për vitin 2011.

Raporti është përpiluar nga të dhënat e ndërmarrjeve publike, zyrave rregullative dhe raporteve të auditorëve të jashtëm, për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, ky raport është përpiluar për të paraqitur tek Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe publiku çështjet me të cilat përballet niveli i tanishëm i shërbimeve dhe zhvillimet që pasojnë për të përmirësuar qeverisjen korporative në sektor.

Prandaj, NJPMNP në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, e cila ka detyrë ligjore të monitorojë dhe raportojë për performancën individuale dhe sektoriale të NP-ve, e ka përgatitur këtë raport, i cili fokusohet në:

- Performancën operative sipas sektorëve dhe sipas Ndërmarrjeve Publike Qendrore;
- Performancën financiare sipas sektorëve dhe sipas Ndërmarrjeve Publike Qendrore;
- Funkionimin e Qeverisjes Korporative;
- Vizionin, Misionin, Objektivat dhe Projektet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Për fund, dëshirojmë të potencojmë se ky dokument paraqet përkushtimin tonë të vazhdueshëm në fushën e përmirësimit të qeverisjes korporative në sektorin e ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, ky paraqet besimin tonë të plotë në realizimin e qëllimit primar për të krijuar një sistem efikas dhe efektiv, i cili do të funksionojë në interes të të gjithë qytetarëve në vend.

2. Qeverisja Korporative

Që nga viti 2006, të gjitha Ndërmarrjet Publike janë korporatizuar dhe funksionojnë sipas qeverisjes korporative, të bazuar në parimet e OECD (Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) për Qeverisje të Korporatave.

Qeverisje korporative do të thotë që ndërmarrja duhet të udhëhiqet nga një bord efektiv, i cili është përgjegjës në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në rastin e një ndërmarrjeje publike, Qeveria e lejon bordin të ushtrojë përgjegjësitë e tij dhe respekton pavarësinë e tij konform infrastrukturës ligjore, kështu që Qeveria nuk duhet të përfshihet në menaxhimin e ndërmarrjeve publike, por vetëm t'i monitorojë, ndërsa duhet t'ua lejojë autonominë e plotë operative për të arritur objektivat e tyre të definuara. Këtë e rregullon edhe Ligji mbi Shoqëritë Tregtare, neni 133, sipas të cilit pas regjistrimit të një shoqërie aksionare dhe pasi që ajo të bëhet person juridik, të gjithë personat ose shoqëritë që ishin themelues të shoqërisë aksionare nuk kanë më autorizim për menaxhimin, ose qeverisjen me të.

2.1 Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike është njësi e themeluar sipas nenit 37 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrje Publike, me qëllim të mbështetjes së Qeverisë dhe Ministrisë në ushtrimin e përgjegjësisë që ia delegon Ligji mbi Ndërmarrje Publike.

2.1.1 Vizioni

Avancimi i Qeverisjes Korporative në funksion të arritjes së qëllimeve kryesore të Aksionarit, ngritja e kualitetit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës dhe rritja e vlerës së asetëve të NP-ve, si pasuri e shtetit të Kosovës.

2.1.2 Misioni

Mbështetja e Qeverisë dhe e Ministrisë për ushtrimin e përgjegjësisë ndaj ndërmarrjeve publike si Aksionar të Ndërmarrjeve Publike, në emër të Republikës së Kosovës, duke ndihmuar në hartimin e politikave pronësore dhe monitorimin e punës së Bordeve të Drejtorëve dhe Ndërmarrjeve Publike Qendrore, në tërësi.

2.1.3 Përgjegjësitë dhe Detyrat e NJPMNP

Përgjegjësitë dhe Detyrat e Njesisë për Ndërmarrjet Publike rrjedhin nga neni 37 i Ligji Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike. Kjo njësi luan një rol kyç në mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, vlerësimin e tyre dhe të bordeve të këtyre NP-ve, si dhe në formulimin e shumë politikave. Disa nga detyrat e Njesisë janë si vijojnë:

- Përgatitja e analizave dhe rekomandimeve lidhur me çështjet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe dorëzimi i tyre tek Ministri, i cili i transmeton në Qeveri;

- Përgatitja e propozim-procedurave për mbikëqyrjen e NP-ve Qendrore dhe monitorimin e përputhjes së tyre me këtë ligj dhe ligjet e tjera të rëndësishme, si dhe dorëzimi i tyre tek Ministri për miratim;
- Mbledhja e të dhënave mbi NP dhe ofrimi i përkrahjes sipas nevojës për NP;
- Bashkëpunimi me divizionin e buxhetit lidhur me të gjitha aspektet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që ndërlidhen me NP;
- Bashkëpunimi me zyrën e Integriteteve Evropiane mbi plotësimin e raporteve me të dhëna nga NP;
- Bashkëpunimi me donatorë, të cilët janë të gatshëm ta ndihmojnë NP në zhvillimin dhe përmirësimin e performancës së tyre me anë të granteve/donacioneve të ndryshme;
- Krijimi i faqes së njesisë në internet dhe publikimi i dokumenteve me rëndësi të NP, siç janë: raportet, deklaratat financiare, statutin dhe rregulloren e NP, planet e biznesit, vendimet e Qeverisë në lidhje me NP, kompensimet e zyrtarëve të lartë, kontratat e prokurimit me vlerë të madhe, konfliktet e interesit, dhjetë furnizuesit më të mëdhenj nga ana e vlerës së furnizimit, numrin e punëtorëve dhe dokumente, ligje apo nënakte të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me NP. Këto të dhëna NJPMNP duhet t'i mbajë në faqen e saj për një periudhë 5 vjeçare;
- Përforcimi i raportimit të rregullt;
- Këshilla për drejtorët e NP-ve dhe sekretarët e ndërmarrjeve;
- Pjesëmarrja në takime të bordit të NP-së në cilësinë e vëzhguesit, në emër të aksionarit;
- Përgatitja dhe procedimi i pagesave të subvencioneve dhe granteve kapitale;
- Përpilimi dhe shpërndarja e udhëzuesit për drejtorët e NP-së;
- Përpilimi dhe shpërndarja e modelit të kodit të etikës dhe qeverisjes korporative pas aprovimit nga aksionari;
- Monitorimi i Bordit të Drejtorëve dhe komisioneve të tjera;
- Rishikimi i përshtatjes së vendimeve të Bordit me rregullativat ligjore në fuqi.

2.1.4 Struktura Organizative




Figure 1 – Struktura Organizative e NJPMNP

2.1.5 Të arriturat e NJPMNP

Gjatë vitit 2011, me qëllim të plotësimit të përgjegjësive që i përcakton ligji, NJPMNP ka arritur t'i përmbushë detyrat si vijojnë:

- Monitorimi i punës së bordeve të drejtorëve përmes shqyrtimit të procesverbaleve të mbledhjeve të bordeve të drejtorëve, komiteteve të auditimit dhe komiteteve të tjera. Gjatë vitit 2011, tek gjashtëmbëdhjetë ndërmarrjet publike qendrore u mbajtën 185 mbledhje të bordeve të drejtorëve, 130 mbledhje të komisioneve të auditimit dhe 73 mbledhje të komiteteve të tjera të përkohshme;
- Në cilësinë e vëzhguesit në emër të aksionarit, analistët e NJPMNP morën pjesë në 37 mbledhje të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore;
- Pranimi, përpunimi dhe procedimi për pagesë i 53 kërkesave të ndërmarrjeve publike, duke realizuar kështu 94% të buxhetit të aprovuar me Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore 2011 për projektet;
- Pranimi, përpunimi dhe procedimi për transfer pagese i 17 kërkesave të ndërmarrjeve publike për subvencione të importit të energjisë, mbulimit të rasteve sociale nga energjia, blerjes së mazutit për ngrohje, shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për pjesën matanë Ibrit dhe kostove operative të lëvizjes së trenit të lirë për qytetarët, duke realizuar kështu 99% të buxhetit të aprovuar me ligj;
- Organizimi dhe përgatitja e mbledhjeve të Komisionit të Ministrave për NP;
- Azhurnimi i ueb faqes me të dhëna mbi NP qendrore;
- Pranimi dhe përpunimi i raporteve tremujore dhe vjetore të NP qendrore;
- Vlerësimi i efektshmërisë së punës së bordeve të drejtorëve të NP qendrore për vitin 2010;
- Hartimi i raportit vjetor mbi performancën e NP qendrore për vitin 2010 dhe përcjellja e saj për në Qeveri dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Organizimi i trajnimeve të bordeve të drejtorëve të NP qendrore;
- Përgatitja e përgjigjeve nga pyetjet e arritura parlamentare dhe të mediave mbi çështjet e NP qendrore.
- Kthimi në rishikim i tri vendimeve të bordit të drejtorëve mbi përputhshmërinë e të njëjtave me ligjin.

2.2 Korniza Ligjore

Pas miratimit të Kushtetutës së Kosovës, në Qershor 2008, është miratuar korniza bazë mbi rregullimin pronësor dhe funksionimin e qeverisjes së korporatave, siç është: Ligji Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrje Publike. Gjithashtu, është bërë edhe amandamentimi i po këtij ligji me Nr. 04/L-111, me të cilin është rregulluar auditimi i NP, komunikimi më i mirë i NP me nivelin lokal, themelimin e NP-ve të reja, si dhe plotësimin e listës së Ndërmarrjeve Publike me ndërmarrje të reja, të cilat më parë ishin nën menaxhimin e AKP.

Janë miratuar edhe aktet e tjera nënligjore si:

- Politikat Pronësore për Ndërmarrje Publike;
- Udhëzimi Administrativ mbi Pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Kompanive Rajonale të Mbeturinave;
- Model-Statuti i Ndërmarrjeve Publike Qendrore;
- Model-kodi i Etikës dhe Qeverisjes së Korporatave;
- Rregullorja mbi Punën e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike etj.

2.2.1 Qeveria si pronare në emër të Republikës së Kosovës

Qeverisja korporative është korniza nga e cila kërkohet të sigurojë që secila ndërmarrje është e drejtuar dhe e menaxhuar në mënyrë të drejtë dhe efikase, duke zbatuar ligjet dhe praktikën e mira dhe me kalimin e kohës kjo i maksimizon kthimet në fondet e aksionarëve. Në një NP, objektiva e biznesit është pak më ndryshe se në një ndërmarrje private, sepse nga entiteti publik pritët t'i përmbush objektivat e caktuara të politikave të vendosura nga Qeveria, të cilat mund të mos jenë të lidhura me maksimizimin e kthimeve në investime, por ndërlidhen me objektivat zhvillimore ekonomike dhe sociale.

2.2.2 Politika Pronësore

Parimi kryesor i qeverisjes së mirë korporative është që ndërmarrja duhet të udhëhiqet nga një bord efektiv, i cili është përgjegjës në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në rastin e një ndërmarrje publike, Qeveria e lejon bordin të ushtrojë përgjegjësitë e tij dhe respekton pavarësinë e tij. Qeveria nuk duhet të përfshihet në menaxhimin e NP-ve dhe duhet t'ua lejojë autonominë e plotë operative për të arritur objektivat e tyre të definuara. Në mënyrë që Qeveria të marrë këtë qëndrim "të mbajë distancë", ajo ka zhvilluar një politikë që definon objektivat e përgjithshme të pronësisë shtetërore, rolin e shtetit në qeverisjen korporative të NP-ve dhe se si ajo do t'i implementojë politikën e saj.

Politika e përgjithshme e Qeverisë për pronësinë e ndërmarrjeve i ka tetë komponenta:

- Qëllimet korporative dhe aktivitetet biznesore;
- Përzgjedhja dhe emërimi i drejtorëve;
- Takimet e Përgjithshme Vjetore;
- Struktura e kapitalit;
- Performanca e ndërmarrjes;
- Dividenda;
- Subvencionet shtetërore; dhe
- Përfshirja e sektorit privat.

Politikat e përgjithshme të lartpërmendura zbatohen për të gjitha NP-të. Përveç këtyre politikave, mund të ketë edhe politika shtesë që mund të jenë specifike për sektorin apo territorin.

Për afarizmin e çdo NP-je, u debatua në mbledhjet e përgjithshme vjetore me Aksionarin në secilën nga NP qendrore, të cilat u mbajtën gjatë Qershorit 2012.

2.2.3 Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative

Neni 35.4 i Ligjit të NP-ve e obligon Ministrin “ta shpallë një model të kodit të etikës dhe qeverisjes korporative për përdorim nga NP-të dhe secila NP duhet të sigurohet që kodi i tyre është konsistent me këtë model të kodit”. Një model i kodit të etikës është përgatitur dhe është përdorur si bazë për sigurimin e angazhimit të drejtorëve të rinj të NP-ve për ta zbatuar kodin, të gjitha rregulloret dhe legjislacionin ekzistues. Të gjithë drejtorët i kanë nënshkruar me kohë zotimet për ta respektuar kodin dhe ndaj të gjithë atyre që nuk e kanë respektuar këtë kod, vlerësimi dhe vendimi për ta do të merret gjatë vlerësimit të bordeve nga Aksionari.

Megjithatë, është paraqitur nevoja për një kod më gjithëpërfshirës dhe më bashkëkohorë dhe për këtë arsye është përpiluar një model i ri i Kodit nga NJPMNP. Modeli i ri i Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative është botuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe është shpërndarë tek të gjitha NP-të.

Në pajtim me Nenin 35.1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, ky model i Kodit:

- E angazhon ndërmarrjen publike për standardet më të larta të sjelljes korporative dhe praktikave biznesore;
- Është i detajuar në mënyrë të mjaftueshme për të dhënë udhëzime të qarta për sjelljet që priten nga të gjithë drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe këshilltarët profesionalë të ndërmarrjes publike.

2.3 Konflikti i interesit

Konflikti i interesit ndodh atëherë kur interesat personale dhe interesat e ndërmarrjes ndërhyjnë, ose bien ndesh me njëra tjetrën. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe delikate në çdo lloj biznesi.

Mënjanimi i këtij lloj konflikti është përcaktuar me Ligj dhe, po ashtu në Kod të Etikës. Aty paraqiten rastet kur kemi të bëjmë me këtë lloj konflikti dhe mënyrat se si t'i mënjanojmë, ose të jemi larg këtyre konflikteve.

Gjatë vitit 2011, mosrespektimi i këtyre dokumenteve ka pasuar me veprime të tjera ligjore, siç ka qenë shkarkimi i drejtorëve joekzekutivë të KEK-ut dhe KRU HidroDrini-Pejë. Vendimet mbi këto shkarkime janë miratuar nga Qeveria pas vërtetimit se kemi të bëjmë me raste të konfliktit të interesit.

2.4 Dividenda

Dividenda është pjesë e cila paguhet nga kompanitë të cilat paraqesin një fitim në fund të vitit dhe mund ta ndajnë një pjesë prej atyre mjeteve për dividende. Duke marre parasysh këshillat e menaxhmentit, Bordi i Drejtoreve, është organi që përcakton se sa mjete nga ky fitim duhet të mbeten për ri-investime dhe sa mund të paguhet për dividendë. Gjatë vitit 2011, PTK është ajo ndërmarrje publike qendrore që ka deklaruar dhe paguar dividendë prej 55 milion euro, ndërsa ANP 'Adem Jashari' ka paguar 5 mil nga deklarimi që kishte bërë në 2010.

2.5 Subvencionet

Qeveria duhet të ketë parasysh sigurimin e subvencioneve në ndërmarrje, në rrethana të caktuara nëse kjo është e përcaktuar me ligjin për ndarje buxhetore. Ja disa shembuj:

- Qeveria kërkon nga ndërmarrja të sigurojë shërbime, ose nivel të shërbimeve, që në rrjedhën normale të biznesit ndërmarrja nuk do ta bëjë atë. Varësisht nga lloji dhe kohëzgjatja e shërbimeve, Qeveria do të përcaktojë nëse subvencionet do të paguhet si shërbime "pro rata" (në proporcion), apo si një shumë fikse;
- Ndërmarrja është duke siguruar shërbime dhe është duke arritur caqet e efikasitetit operativ, mirëpo të hyrat nuk i mbulojnë shpenzimet. Nëse, për t'i mbuluar shpenzimet, ndërmarrja dëshiron t'i rrisë tarifën e saj, por Autoriteti Rregullativ vendosë mos të sanksionojë rritjen e tarifave në nivelin e dëshiruar nga ndërmarrja, Qeveria mund të sigurojë subvencione për ta mbuluar "boshllëkun"; ose
- Granti kapital do të ishte i nevojshëm drejt financimit të investimeve të mëdha në rast kur: (i) asetet fizike ekzistuese janë pranë përfundimit të jetës së tyre ekonomike; ose (ii) shfrytëzimi i teknologjisë së re do ta zvogëlojë ndjeshëm koston e operimit; ose (iii) kapaciteti ekzistues është i pamjaftueshëm dhe kërkohen investime për t'i zgjeruar kapacitetet.

Gjatë vitit 2011, bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Qeveria përmes MZHE ka mbështetur me mjete financiare Ndërmarrjet Publike Qendrore e Lokale me buxhet të përgjithshëm prej: 47.8 milionë euro, nga të cilat:

- 35.5 milionë euro janë subvencione për import të energjisë, ngrohje qendrore, hekurudha, dhe ujë e mbeturina;
- 12.3 milionë euro janë projekte kapitale.

2.6 Përfshirja e sektorit privat dhe ristrukturimi i Ndërmarrjeve Publike

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, neni 60, Qeveria është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut dhe si rezultat i kësaj inkurajohet përfshirja e sektorit privat në mënyrë aktive në ndërmarrje publike, ku një përfshirje e tillë do të sigurojë përfitim të përgjithshëm për popullin e Kosovës, duke pasur parasysh:

- efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve të shpërndara nga ndërmarrja;
- ndikimin e përgjithshëm ekonomik të strukturave alternative të pronësisë;
- kapaciteti i buxhetit të Qeverisë për të bërë investime në ndërmarrje që janë të nevojshme për të shpërndarë shërbime në të ardhmen; dhe
- natyra e konkurrencës brenda sektorit në të cilin ndërmarrja operon.

Baza ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe futjen e kapitalit privat përmes PPP, është e garantuar me nenin 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është e përcaktuar me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 03/L-090 mbi Partneritetin Publiko- Privat.

Ristrukturimi i ndërmarrjeve si implementim i politikave pronësore ndaj ndërmarrjeve publike shtetërore, me qëllimin të ngritjes së kualitetit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës është proces që ka filluar dhe është në vazhdimësi, si:

- Hekurudhat e Kosovës sh.a. mbështetur në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 03/L-076 dhe Vendimit të Qeverisë 05/110, është ndarë në dy kompani, njëra për operime (Trainkos sh.a.) dhe tjetra për infrastrukturë (Infrakos sh.a.)
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (Adem Jashari) është ndarë në dy kompani, njëra që merret me operimin e fluturimeve ajrore dhe ofrimin të shërbimeve për udhëtarë, e cila është koncesionuar nga LimakLyon për 20 vjet, mbështetur në ligjin për PPP nr. 04/L-045, dhe kompania tjetër që merret me kontrollin ajror dhe që ka mbetur në pronësi shtetërore.
- Nga Korporata Energjetike e Kosovës-KEK, është themeluar si kompani e pavarur Distribucioni dhe Furnizimi (KKDFE). KKDFE në fund të vitit 2011 ishte në fazën finale të procesit të privatizimit, dhe i cili proces u finalizua në 2012.
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK, sipas Vendimit të Qeverisë në fund të vitit 2011 kishte filluar ndarjen me qëllim të themelimit të Postës së Kosovës. Kjo ndarje pason sipas Strategjisë së Privatizimit të PTK. Posta e Kosovës do të mbetet pronë e shtetit dhe PTK që përmban shërbimin e telefonisë fikse, telefonisë mobile dhe internetin, 75% nga aksionet do t'i nënshtrohet procesit të privatizimit. Procesi i ndarjes së PTK-së është finalizuar me 01 gusht 2012, dhe tani veprojnë si dy entitete të ndara biznesore: PTK dhe Posta e Kosovës.
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës është në fazën e studimit të opsioneve nga Këshilltari i Transaksionit-IFC mbi mënyrën e ristrukturimit të saj. Është në shqyrtim mundësia për Investime për ngritjen dhe modernizimin e Deponive në Kosovë (4 deponi dhe 1 stacion i transferit), ku kapaciteti i përgjithshëm i Deponive është më shumë se 180,000 tonë mbeturina. Për Këshilltar Trasaksioni është përzgjedhur IFC, i cili do ta kryejë Studimin e Fizibilitetit dhe Opsionet e Kontraktimit. Në maj 2011 është mbajtur Konferenca e Investitorëve në Prishtinë. Deri në periudhën e raportimit IFC ka dorëzuar Raportin e Opsioneve Strategjike për PPP në KDMK. Projekti për momentin është ndalur, për arsye të Projektligjit për Mbeturina dhe një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbeturinave.

2.7 Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike

2.7.1 Bordi i Drejtorëve

a) Përgjegjësitë dhe Detyrat

Bordi duhet të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti rreth sjelljes së zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes duke përjashtuar Auditorin e Brendshëm, rreth të cilit Komisioni i Auditimit ka kompetenca ekskluzive.

Bordi duhet të jetë i kujdesshëm që mos të lejojë përgjegjësitë e tij për të monitoruar performancën e tanishme të cilat mund të largojnë vëmendjen nga rolet thelbësore për të ofruar udhëheqësi strategjike afatgjatë të biznesit. Kur bëhet thirrje për ndonjë ndryshim strategjik, roli i Bordit është të angazhohet, të udhëheqë dhe të monitorojë afarizmin si një ekip i bashkuar.

Bordi duhet gjithmonë të nxjerrë vendime në mënyrë objektive, për interesat më të mira të ndërmarrjes dhe aksionarëve të saj. Drejtorët kanë përgjegjësinë themelore për ndërmarrjen dhe arritjen e suksesshme të objektivave të saj. Ata duhet ta bëjnë këtë në mënyrë etike brenda kornizës së ligjeve dhe nënligjeve që e udhëheqin drejtimin e ndërmarrjes.

Përgjegjësitë e tjera të Bordit janë:

- Të përcaktojë misionin dhe qëllimin e ndërmarrjes;
- Të takohet mjaftueshëm në baza të rregullta që t'i kryej detyrat e tij në mënyrë efikase dhe duhet të ketë një orar zyrtar për vendimet që do t'i marrë;
- Të pranojë informata të sakta, të qarta dhe me kohë, ndërsa menaxhmenti duhet të sigurojë informata të tilla dhe drejtorët duhet të kërkojnë sqarime;
- Të shqyrtojë dhe aprovojë planin e biznesit të ndërmarrjes nga i cili vendosen qëllimet specifike dhe të matshme, si dhe monitoron implementimin e planit të biznesit;
- T'i rishikojë rreziqet kryesore në biznes, të sigurohet që janë të vendosura mirë menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli dhe t'i rishikojë në baza të rregullta në dritën e ndryshimeve dhe objektivave strategjike të Ndërmarrjes;
- Të sigurojë burime të mjaftueshme për operimet e ndërmarrjes;
- Të inkurajojë dhe ruajë linjat e hapura të komunikimit;
- Të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë zyrtarët e lartë të NP, si dhe ta monitorojë dhe vlerësojë performancën e zyrtarëve të lartë të NP;
- Ta mbajë menaxhmentin përgjegjës duke përdorur mekanizmat e tillë si kompensimin dhe punësimin e vazhdueshëm;
- Ta zgjerojë imazhin e Ndërmarrjes, si dhe ta vlerësojë performancën e saj;
- Të raportojë tek aksionarët për performancën e ndërmarrjes dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative; dhe

- Kur shqetësimet e drejtorëve lidhur me drejtimin e Ndërmarrjes, ose veprimet e propozuara nuk mund të zgjidhen, duhet të siguroheni që ato janë të regjistruara në procesverbalin e bordit.

b) Procesi i selektimit

Për çdo NP, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit do të emërojë një Komision Rekomandues prej shtatë (7) personave që të identifikojë dhe rekomandojë Qeverisë kandidatët për pozitën e drejtorit në bordin e NP-së përkatëse.

Bordi i Drejtorëve të një NP Qendrore do të përbëhet nga pesë, ose shtatë drejtorë. Të gjithë drejtorët, përveç njërit, do të zgjidhen nga Qeveria, përjashtim bëhet tek kompanitë rajonale të ujit, në bordet e të cilave pjesëmarrja e komunave do të jetë 50% nga përbërja dhe secili drejtor i zgjedhur në këtë mënyrë shërben me mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

Gjatë zgjedhjes së drejtorëve të bordit të drejtorëve të një NP Qendrore, Qeveria mund të zgjedhë vetëm personat të cilët i janë rekomanduar Qeverisë nga Komisioni përkatës Rekomandues dhe nominimet e komunave për kompanitë rajonale të ujit. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Qeveria duhet të sigurojë që së paku dy (2) drejtorë të jenë ekspertë, ose së paku të kenë njohuri adekuatë të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 të këtij ligji.

c) Kompensimi

Drejtorëve do t'u paguhet një honorar themelor, i cili është përcaktuar me një Vendim të Qeverisë, për kohën e shpenzuar në mbledhjet e Bordit.

Drejtorëve, po ashtu do t'u paguhet një kompensim për stimulimin e efektshmërisë në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit, e cila përgatitet dhe zbatohet nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve.

Mosrespektimi i Vendimit të Qeverisë dhe deklaratës mbi politikën e Kompensimit do të sjellë efekte negative gjatë vlerësimit të bordit përkatës, si dhe do të merren masa tjera.

d) Vlerësimi/vetëvlerësimi i BtD

Çdo bord i ndërmarrjes publike ka për detyrë ta bëjë vetëvlerësimin për punën e tyre gjatë vitit paraprak. Për t'i ardhur në ndihmë me këtë proces të ri të vetëvlerësimit, që ndodh në vendin tonë, NJPMNP ka përgatitur një model me pyetje të ndryshme dhe në bazë të saj, bordi i NP ka përgatitur vetëvlerësimet e tyre për vitin 2011 dhe e ka dorëzuar atë me kohë tek NJPMNP.

Gjithashtu, NJPMNP ka përgatitur një raport vlerësimi për secilin bord të NP, duke u mbështetur në performancën operative dhe financiare, respektivisht arritjen e caqeve operative dhe financiare nga Plani i Biznesit, sikurse edhe përmbushja e kërkesave ligjore mbi raportimet e tyre, pasqyrat financiare dhe operative, mbajtjen e mbledhjeve dhe seriozitetin e tyre në punë. Ky raport ka arritur të paraqesë një vlerësim të efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve, i cili raport është i

publikuar në ueb faqen e NJPMNP-MZHE, ndërsa Aksionari me rastin e përzgjedhjes së bordeve të reja do të ketë parasysh vlerësimin e dalë nga ky raport për të aplikuarit që deri më tani ishin anëtarë bordi.

2.7.2 Menaxhmenti

a) Zyrtarët e NP

Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mund në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre, me ose pa deklarin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mund në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari, me ose pa deklarin e arsyes. Neni 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në rregulloret e NP-së. Rregulloret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve sipas Neni 34, ndër tjera, do ta përcaktojnë titullin, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit zyrtar të NP-së.

Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë, si në vijim: Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin Korporativ dhe një Zyrtar për Auditim të Brendshëm. Nëse është e nevojshme, për shkak të madhësisë dhe/ose llojllojshmërisë së veprimtarive, NP mund, nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore, që po ashtu të ketë një, ose dy poste të Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv.

2.7.3 Raportimet

Ashtu si në çdo biznes, apo institucion, edhe ndërmarrjet publike duhet të përgatisin raporte të ndryshme dhe të cilat duhet të jenë në dispozicion për Drejtorët e Bordeve të NP, si dhe për NJPMNP, sipas kërkesës së tyre.

Ligji mbi NP është një kornizë ligjore që i obligon të gjitha NP të raportojnë në datë të caktuar raporte të caktuara. Disa nga raportet janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Raportimet	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike
Raporti i Tremujorit të Parë	Deri më 31 Maj
Raporti i Tremujorit të Dytë	Deri më 31 Gusht
Raporti i Tremujorit të Tretë	Deri më 30 Nëntor
Raporti Vjetor	Deri më 17 Mars
Plani i Biznesit	Deri më 31 Tetor
Raporti i Kënaqshmërisë së Konsumatorit	Deri me 31 Mars
Raporti i Auditorit të Jashtëm	Deri më 30 Maj
Raporti i Auditorit të Brendshëm	Raporton tek Komisioni i Auditimit

Tabela 1 - Raportimet në bazë të ligjit mbi NP

a) Raportet Tremujore dhe Vjetore

Gjatë vitit 2011, të gjitha NP-të i kanë dorëzuar këto raporte. Disa nga ndërmarrjet kanë përdorur format e përcaktuara nga to, ndërsa disa të tjera kanë përdorur formën e përcaktuar nga NJPMNP (për raportin vjetor), si dhe janë mbështetur në nenin 31 të Ligjit mbi Ndërmarrje Publike. Në pjesën e tretë të këtij raporti është dhënë një sqarim më i detajuar rreth raporteve të secilës ndërmarrje.

b) Plani i Biznesit

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, zyrtarët e secilës ndërmarrje publike duhet ta përgatisin planin e biznesit deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik për vitin e ardhshëm. Ky biznes-plan mund të rishikohet nga ndërmarrja pas gjashtëmuajorit të parë. Në vitin 2011 të gjitha NP-të e kanë përgatitur Planin e tyre të Biznesit për vitin 2012.

c) Raporti i Kënaqshmërisë së Konsumatorit

Çdo ndërmarrje publike, po sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi NP, ka për detyrë ta testojë kënaqshmërinë e konsumatorëve të tij/saj ndaj shërbimeve që ofrojnë. Në bazë të testimit duhet ta përgatisë një raport, të cilin duhet ta dorëzojë tek NJPMNP. Përveç katër NP-ve, të cilat nuk kanë arritur ta dorëzojnë këtë raport, të gjitha NP-të e tjera e kanë dorëzuar në afat raportin në fjalë.

d) Auditimi i Jashtëm

Pas përfundimit të çdo viti, të gjitha ndërmarrjet publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi i jashtëm kryhet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, apo zgjidhet nga ndërmarrja publike me anë të një procesi përzgjedhës në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik. Ky auditor ka për detyrë ta përgatisë një vlerësim sa më real dhe profesional të pasqyrave financiare të ndërmarrjes, si dhe të performancës së saj në çdo aspekt. Raporti i Auditorit të Jashtëm duhet të paraqitet tek Bordi i Drejtorëve për informim dhe miratim, si dhe të dërgohet tek Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Tek të gjitha ndërmarrjet ka përfunduar auditimi i jashtëm për vitin 2011, raporti i fundit, ai i PTK-së, është pranuar në fund të korrikut 2012.

Raportet rezultojnë me opinione mbi përputhshmërinë dhe rregullsinë e pasqyrave financiare dhe proceseve të kontrollit të brendshëm me standardet dhe kërkesat ligjore, ku kemi opinionet si: dhjetë nga to kanë opinion të pakualifikuar, një ka opinion të kualifikuar dhe gjashtë si të kualifikuar me theksim çështjeje. Në krahasim me vitin paraprak, ky është një progres në opinionet e auditorëve të jashtëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e performancës së menaxhimit tek kompanitë e ujit dhe kompania e menaxhimit të deponive të Kosovës. Nga raportet e auditimit kanë dalë disa rekomandime mbi të gjeturat. Të gjeturat janë marrë me seriozitet të lartë dhe

është punuar Plani i Implementimit të Rekomandimeve, i cili tanimë pothuajse është implementuar.

e) Auditori i Brendshëm

Ligji mbi NP e parasheh Auditorin e Brendshëm si një nga zyrtarët e lartë më të rëndësishëm të NP.

Përzgjedhja e Auditorit të Brendshëm është kompetencë e Komisionit të Auditimit, sikurse që është përgjegjësi edhe e miratimit të Planit të Punës dhe miratimit të Raporteve të Auditorit të Brendshëm.

Të gjitha ndërmarrjet publike kanë auditorë të brendshëm, ndërsa NP-të e mëdha, siç janë KEK-u dhe PTK-ja posedojnë edhe ekipe të auditorëve, të cilët japin një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të kontrollit të brendshëm.

3 Ndërmarrjet Publike

Ndërmarrjet Publike në Kosovë, nga aspekti i pronësisë, ndahen në Ndërmarrje Qendrore me aksionar Qeverinë e Kosovës, në emër të Republikës së Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike Lokale, nën pronësinë e komunave.

Nga aspekti i shtrirjes dhe organizimit ekzistojnë edhe Ndërmarrjet Publike Regjionale, të cilat mund të jenë me pronësi edhe qendrore edhe lokale si p.sh: Kompanitë Regjionale të Ujësjellësve, apo Kompanitë Regjionale të Mbeturinave.

Ndërmarrjet Qendrore janë ndërmarrje në pronësi të Qeverisë, në emër të Republikës së Kosovës dhe monitorohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Kjo njësi është përcaktuar në Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike që ta luajë rolin e monitoruesit nga aksionari. Ndërsa, ndërmarrjet lokale janë në pronësi të komunave përkatëse dhe monitorohen nga këto komuna përmes Komisionit të Aksionarëve.

3.1 Sektorët e Ndërmarrjeve Publike

Ndërmarrjet Publike Qendrore kryejnë shërbime në sektorët:

- **Sektori i Energjisë:**
 - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK);
 - Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT).

- **Sektori i Komunikimeve:**
 - Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK).

- **Sektori i Transportit:**
 - Aeroporti Ndërkombëtar i Kosovës “Adem Jashari” (ANP);
 - Hekurudhat e Kosovës (HK)
 - Infrakos
 - Trainkos.

- **Sektori i Ujërave:**
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina;
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi ;
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava;
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor;
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidrodrini;
 - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica;
 - Kompania Rajonale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini;
 - Kompania Rajonale e Ujitjes Drini i Bardhë;
 - Ndërmarrje Hidro Ekonomike Ibër-Lepenc.

- **Sektori i Mbeturinave:**
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK).

3.2 Politikat Zhvillimore, Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Ndërmarrjeve Publike




Figure 2 – Administrimi i NP

Figura 2 tregon se si funksionojnë NP-të në raport me aksionarin, ministrinë e linjës që bëjnë politikat zhvillimore të sektorit, Rregullatorin dhe qytetarin, të cilit i ofrohen shërbimet publike.

NP është entitet biznesor që punon për profit, por meqenëse është themeluar nga publiku, atëherë përgjegjësia e saj është të ofrojë shërbime ndaj qytetarëve. Politikat e zhvillimit përcaktohen nga ministria e linjës, politika këto që pranohen në Planin e Biznesit, i cili monitorohet nga bordi i drejtorëve dhe po këtë Bord dhe punën e tij e monitoron NJPMNP-MZHE. Ndërsa, Zyrat Rregullative caktojnë tarifën, bëjnë licencimin e NP-ve dhe mbikëqyrin kualitetin e shërbimeve të NP-ve.

3.3 Përkrhja Financiare nga Qeveria

Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lokale	2011		2010	
	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)
PTK	0	0	0	0
RTK	0	0	0	10,464
KEK ¹	0	31,833	0	33,520
KOSTT	7,385	0	8,339	0
ANP	0	0	0	0
Hekurudhat e Kosovës	0	0	2,682	500
Infrakos	603	0	0	0
Trainkos	1,198	500	0	0
Ibër-Lepenc	0	0	0	0
Ndërmarrjet e Ujërave dhe Hedhurinave	2,667	1,266	2,651	587
Ngrohja Qendrore	474	1,948	449	1,403
Gjithsej sipas Kategorive	12,327	35,547	14,121	46,474
Gjithsej NP-të Qendrore dhe Lokale	47,874		60,595	

Tabela 2- Mjetet e ndara nga Qeveria për NP

Nga tabela 2 vërehet se në përputhje me KASH-in dhe në koordinim me FMN, Qeveria ka bërë reduktimin e subvencioneve për 26.5%, në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes projekteve të reja, ka investuar 12.3 milionë euro në ndërmarrjet publike si KOSTT, Hekurudha dhe NP të Ujërave dhe Mbeturinave.

Gjithashtu, gjatë po kësaj periudhe, Qeveria ka subvencionuar Ndërmarrjet Publike, siç janë KEK, Trainkos, Ndërmarrjet e Ujërave dhe Hedhurinave, si dhe Ngrohjet Qendrore, me një shumë rreth 35.5 milionë euro. Kjo ka qenë një ndihmë financiare e dhënë nga Qeveria me qëllim të sigurimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike, mbulimit të kostove operative për qarkullimin e trenit të lirë për qytetarët, sigurimit të ngrohjes qendrore, si dhe mbulimit të kostove për shërbime të ujit dhe mbeturinave.

¹ Në shumën e subvencioneve për vitin 2010 dhe 2011 është përfshirë edhe subvencioni i energjisë elektrike për raste sociale me vlerë 4,500,000 (2010) dhe 4,483,493 (2011).

3.4 Performanca Financiare e NP-ve

Ndërmarrjet Publike Qendrore	2011			2010		
	Të hyrat ² (000€)	Kostot ³ (000€)	Profiti/Humbja ⁴ (000€)	Të hyrat (000€)	Kostot (000€)	Profiti/Humbja (000€)
ANP “Adem Jashari”	8,958	-8,562	396	28,064	-21,886	6,178
KEK	257,496	-240,979	16,517	239,013	-224,865	14,148
KOSTT	18,792	-17,509	1,283	22,725	-18,257	3,468
PTK	164,297	-118,181	46,116	154,049	-120,653	33,396
Hekurudhat e Kosovës ⁵	5,896	-8,196	-2,300	7,927	-7,992	-65
Infrakos ⁶	1,337	-1,420	-83			
Trainkos ⁷	2,364	-2,016	348			
KMDK	1,187	-2,098	-911	1,116	-2,077	-961
Ibër-Lepenc	3,810	-7,800	-3,990	5,379	-7,713	-2,334
KRU Drini i Bardhë	227	-244	-17	170	-244	-74
KRU Radoniqi-Dukagjini	887	-885	2	810	-839	-29
KRU Prishtina	12,941	-13,265	-324	11,611	-13,550	-1,939
KRU Mitrovica	3,775	-3,713	62	3,248	-3,630	-382
KRU Hidromorava	1,716	-2,068	-352	1,719	-2,105	-386
KRU Hidrodrini	3,067	-3,220	-153	3,003	-3,239	-236
KRU Radoniqi	2,924	3,601	-677	2,729	-3,435	-706
KRU Hidroregjioni Jugor	3,579	-4,075	-496	2,908	-3,441	-533
TOTAL	493,253	-437,832	55,421	484,471	-434,926	49,545

Tabela 3 - Performanca Financiare e NP bazuar në raportet e auditorit të jashtëm

Në tabelën 3 vërejmë një progres në krahasim me vitin paraprak, ngase si rezultat i rritjes së të hyrave kemi një fitim të përgjithshëm vjetor në 2011 për 11.8% më të madh sesa në vitin paraprak.

Ndërsa, individualisht shihet qartë progresi si: që dy kompani kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare; dy të tjera kanë arritur t’i kthejnë kompanitë e tyre në kompani fitimprurëse, ndërsa shtatë nga to kanë arritur t’i zvogëlojnë humbjet e tyre nga viti paraprak.

Një performancë edhe më e mirë do të ishte e mirëseardhur edhe nga kompanitë si: ANP, KOSTT dhe Ibër-Lepenc. Mirëpo, kjo nuk kishte ndodhur nga arsyet objektive, pasi që ANP është koncesionuar dhe nuk i ka më operimet, KOSTT ka kërkesa kontestuese për realizim nga KEK dhe Ibër-Lepenc nuk ka mundur të krijojë të hyra më të mëdha që rrjedhin nga gjenerimi i energjisë përmes Hidrocentralit për shkak të kushteve jo të favorshme hidrologjike.

² Tek të hyrat përfshihen të hyrat edhe nga grantet

³ Përfshihet edhe amortizimi, borxhet e këqija, etj.

⁴ Profiti/Humbja pas tatimit

⁵ Viti 2011 përfshin periudhën 01/01/2011-31/08/2011

⁶ Të dhënat për periudhën 01/09/2011-31/12/2011

⁷ Të dhënat për periudhën 01/09/2011-31/12/2011

3.5 Performanca Operative e Sektorëve

- **Sektori i Energjisë**

Indikatorët Operativë	Prodhimi i Qymyrit në ton (000)	Prodhimi i Energjisë (GWh)	Humbjet teknike (%)	Humbjet komerciale (%)	Faturimi i Energjisë në dispozicion për shitje (%)	Inkasimi si (%) e faturimit	Humbjet në Transmision		Kapaciteti i Transformatorëve (MVA)
							MWh	%	
2010	7,958	5,037	17.2	24.02	80	88.6	131	2.38	1500
2011	8,212	5,167	16.78	21.37	74.35	91.08	115	2.06	1800

Tabela 4 - Performanca Operative e Sektorit të Energjisë⁸

Nga tabela 4 vërehet se sektori i energjetikës ka progres të theksuar gjatë operimeve në krahasim me vitin paraprak.

Siç shihet, këtë vit në krahasim me vitin paraprak është prodhuar më shumë thëngjill për 3.2%, është gjeneruar më shumë energji për 2.6%, është inkasuar më shumë nga faturimi për 2.48%, ndërsa janë zvogëluar humbjet e përgjithshme të energjisë (teknike dhe komerciale) në KEK për 3.07%.

Gjithashtu, në KOSTT janë reduktuar humbjet në transmision për 0.32% dhe është rritur kapaciteti i transformatorëve nga 1500 MVA në 1800 MVA.

- **Sektori i Telekomunikimit**

Tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit në Kosovë kap vlerën e 250 mil eurove, pjesën më të madhe të të cilit, apo 80%, e përfshin telefonia mobile, pjesa tjetër mbulohet nga telefonia fikse dhe interneti.

Në Kosovë, PTK me të hyra mbulon 70% të telefonisë mobile, 95% të telefonisë fikse dhe vetëm 25% të Internetit.

Indikatorët Operativë	Telefonia Fikse (Telekomi)		Telefonia Mobile (Vala)		Interneti	
	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)
2010	82,805	93.7	1,018,400	70.15	42,981	34
2011	82,238	94.4	992,963	67.14	36,427	25.43

Tabela 5 - Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit⁹-PTK

Nga tabela 5 vërehet se ka progres vetëm tek mbulueshmëria e tregut nga telefonia fikse, mirëpo edhe aty kemi një zvogëlim te numri i konsumatorëve.

⁸ Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2011 i ZRrE

⁹ Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2011 i ART

Ndërsa, tek të gjithë indikatorët e tjerë, si Vala dhe Interneti, ka një rënie në numër të konsumatorëve dhe një rënie në mbulueshmërinë e tregut në %.

Kjo rënie mund të ketë ndodhur si pasojë e konkurrencës nga operatorët e tjerë në treg.

Zvogëlimi i konsumatorëve të telefonisë mobile nga përgjegjësit e PTK-ës shpesh shpjegohet si pasojë e reregjistrimit të ri të konsumatorëve dhe pastrimit të regjistrit nga numrat pasiv.

- **Sektori i Ujit**

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, të ofruar nga kompanitë publike, paraqesin ofruesin kryesorë të këtyre shërbimeve në Kosovë. Aktualisht numri i popullatës së shërbyer nga KRU është rreth 1.375.000, apo rreth 70%, të cilët pranojnë shërbimin e ujësjellësit, përderisa vetëm 50% marrin shërbime të kanalizimit në raport me totalin e popullatës së Kosovës.

Indikatorët operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	139,424,837	133,304,780
Faturimi i ujit (%)	39	40
Inkasimi i ujit (%)	68	65
Uji i pafaturuar (%)	61	60
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	79	80
Numri i konsumatorëve	238,852	223,446

Tabela 6 - Performanca Operative e Sektorit të Ujit¹⁰

Nga të dhënat e tabelës 6 vërehet se tek sektori i ujit të pijshëm kemi një progres tek prodhimi i ujit për 4.5% në krahasim me 2010. Po ashtu, është rritur inkasimi nga faturimi për 3%, sikurse që është rritur numri i konsumatorëve për 15.406 konsumatorë të rinj. Mirëpo, duhet të punohet akoma për të arritur një progres më të madh, pasi që në vitin 2011 kishte edhe indikatorë në rënie, siç është përqindja e faturimit, apo humbja e ujit e cila është rritur për 1%.

¹⁰ Të dhënat janë marre nga Raporti Vjetor 2011 | ZRRUM

3.6 Numri i punëtorëve të NP

Ndërmarrjet Publike Qendrore	Numri i punëtorëve	
	2011	2010
ANP “Adem Jashari”	159	821
KEK	7714	7705
KOSTT	242	239
PTK	3349	3357
Hekurudhat e Kosovës	-	468
Infrakos	291	-
Trainkos	203	-
KMDK	52	46
Ibër Lepenc ¹¹	273	238
KRU Drini i Bardhë ¹²	56	45
KRU Radoniqi-Dukagjini	64	66
KRU Prishtina	536	504
KRU Mitrovica	229	220
KRU Hidromorava	153	142
KRU Hidrodrini	180	179
KRU Radoniqi	228	220
KRU Hidroregjioni Jugor	237	220
Totali	13,966	14,470

Tabela 7 - Numri i Punëtorëve në NP

Nga të dhënat e tabelës 7 mund të konstatojmë se numri total i të punësuarve ka rënie për 504 të punësuar, e cila është paraqitur si rezultat i koncesionimit të ANP dhe kalimit të një pjese të punonjësve tek operatori privat, bazuar në marrëveshjen mes shtetit dhe operatorit për vazhdimin e kontratave trevjeçare të punëtorëve, përndryshe nr. i të punësuarve në NP të veçanta është rezultat i implementimit të planeve të biznesit dhe finalizimit të projekteve të reja.

¹¹ Nr. i punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal.

¹² Nr. i punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal.

4 Performanca individuale e Ndërmarrjeve Publike Qendrore

4.1 KEK

Emri i Kompanisë	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. (KEK)
Numri i Regjistrimit	70325399
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Fadil Çitaku (Kryesues) Izet Ibrahim Mujë Rugova Ismail Jonuzi Flamur Keqa Agim Nika
Kryeshefi Ekzekutiv	Arben Gjukaj
Sekretari i Kompanisë	Nexhat Podrimaj
Drejtori Financiar	Salih Bytyqi
Auditori i Brendshëm	Mentor Hyseni

Tabela 8 - Të dhënat e përgjithshme të KEK-ut

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK), është ndërmarrja e vetme energjetike në Republikën e Kosovës. Ajo është korporatizuar në fund të vitit 2005. KEK-u operon me dy mihje sipërfaqësore (mihja e Mirashit dhe mihja e Bardhit), dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B), si dhe rrjetin e shpërndarjes që ka një gjatësi rreth 18.898.43 km dhe shtrihet në të gjithë sipërfaqen e vendit tonë. Po ashtu, ka edhe sektorin e furnizimit, ku përfshihet edhe sektori i shitjes së energjisë elektrike.

Ndër funksionet parësore të KEK-ut janë prodhimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike dhe shpërndarja e saj, shitja e energjisë, si dhe përkujdesja ndaj konsumatorëve. Për t'i arritur të gjitha funksionet e saj, kjo ndërmarrje është e ndarë në 4 divizione kryesore. Ato janë:

- Divizioni i mihjes (prodhimi i qymyrit);
- Divizioni i gjenerimit (prodhimi i energjisë elektrike);
- Divizioni i shpërndarjes (shpërndarja e energjisë); si dhe
- Divizioni i furnizimit (furnizimi me energji elektrike).

Funksionet e Korporatës rregullohen përmes politikave të Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me energji elektrike të mjaftueshme për shfrytëzuesit finalë me çmime sa më të favorshme, duke respektuar standardet mjedisore.

Misioni

Ofrimi i shërbimeve energjetike të besueshme dhe të bazuara në kosto për të gjithë konsumatorët që paguajnë, duke zbatuar rregulloret për siguri dhe shëndet dhe duke zbatuar standardet mjedisore, duke i tërhequr investimet, me qëllim të mbajtjes së realizueshmërisë financiare dhe zhvillimit. Të gjitha këto gjithmonë në ruajtje të aseteve të kompanisë përmes mirëmbajtjes së duhur dhe përkrahjes së vlerave thelbësore të kompanisë, si transparenca dhe sjellja etike.

Objektivat

Objektivat e kësaj ndërmarrjeje kanë të bëjnë me sigurimin e saj si një organizatë efektive dhe e gatshme për t'u përballur me çdo sfidë të së ardhmes. Disa nga objektivat janë të radhitura më poshtë:

- Përmirësimi i performancës financiare të KEK-ut përmes inkasimit 100% të energjisë në dispozicion për shitje;
- Menaxhimi dhe operimi efikas i aseteve;
- Përgatitja e aseteve të shturura funksionalisht dhe ligjërisht (miniera, gjenerimi, rrjeti dhe furnizimi) për tërheqjen e investimeve dhe privatizimi potencial;
- Rritja e investimeve në mbrojtjen e ambientit;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare;
- Rritja e përgjegjësisë ndaj konsumatorëve dhe shoqërisë;
- Rritje e produktivitetit;
- Aftësimi i fuqisë punëtore;
- Ruajtja e marrëdhënieve me publikun dhe Qeverinë.

Projektet

Projektet kryesore gjatë vitit 2011, të ndara sipas divizioneve, janë si vijon:

Divizioni i Mihjeve

- Hapja dhe operimi i minierës Sibovci Jugperëndim, burimi i financimit: hua nga Qeveria);
- Palosësit SD II&III, P3&P4M, burimi i financimit: KEK-u;

Divizioni i Gjenerimit

- Riparimi kapital i gjeneratorëve në TCB, burimi i financimit: KEK-u;
- Riparimi i termoizolimit në TC B, burimi i financimit: KEK-u;

Divizioni i Rrjetit

- Rindërtimi i nënstacionit Palaj, si dhe bartja e transformatorit dhe vendosja në TS 110/35 kV – Prizreni 1, burimi i financimit: KEK-u;
- Zgjerimi dhe përforcimi i rrjetit distributiv i KEK-ut, burimi i financimit: KEK-u.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ dhe divizional të korporatës gjatë 2011. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë në çdo njësi të biznesit të saj, si dhe treguesit kyç që do të arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar nga komisioni i auditimit dhe aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, arritjet e divizioneve, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare të divizioneve, duke i krahasuar me të dhënat e një viti paraprak, si dhe me planin e biznesit duke treguar se cilat planifikime janë realizuar plotësisht dhe cilat pjesërisht.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë viti 2011, (14 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse para çdo mbledhje të bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 10 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilët kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komisione janë: Komisioni për Minierën e Sibovcit Jugperëndimor, Komisioni për Përcjelljen e Projekteve Mjedisore dhe Komisioni për Vlerësimin e Marrëveshjes për Furnizim me Energji të Konsumatorëve me Tarifa të Parregulluara.

Njësia ka përcjellë punën e këtij bordi dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së tij dhe shih për këtë vlerësimi i NJPMNP në raportin që është e publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	Prodhimi i qymyrit në ton (000)	Prodhimi i energjisë (GWh)	Humbjet teknike (%)	Humbjet komerciale (%)	Faturimi i energjisë në dispozicion për shitje (%)	Inkasimi si (%) e faturimit
2010	7,958	5,037	17.2	24.02	80	88.6
2011	8,212	5,167	16.78	21.37	74.35	91.08


Tabela 9 - Performanca Operative e KEK-ut

Siç shihet në tabelën 9 në të gjithë indikatorët kyç të performancës (IKP), divizionet kanë shënuar progres të dukshëm. Në krahasim me vitin 2010, performanca e vitit 2011 ka rezultuar në rritje të prodhimit të qymyrit dhe energjisë, inkasimi gjithashtu është rritur, kurse humbjet teknike dhe komerciale kanë shënuar rënie.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	257,496	239,013
Shpenzimet	-184,910	-173,617
Fitimi/Humbja operative	72,586	65,396
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-37,711	-29,163
Borxhet e këqija	-18,358	-22,085
Fitimi/Humbja financiare	16,517	14,148
Paraja në fund të vitit	49,561	37,320

Tabela 10 - Performanca Financiare e KEK-ut



Grafiku 1 – Fitimi/Humbja Financiare, KEK



Grafiku 2 – Paraja ne fund te vitit, KEK

Tabela 10 tregon se të hyrat në vitin 2011 në KEK kanë rritje 7.7% në krahasim me vitin paraprak dhe fitimi financiar vjetor ka pasur rritje prej 16.7%, ndërsa shpenzimet për borxhet e këqija janë zvogëluar për 20.3%.

4.2 KOSTT

Emri i Kompanisë	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu, sh.a. (KOSTT)
Numri i Regjistrimit	70325350
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Ramadan Paçarada (U.D Kryesues) Faton Deda Nazmi Mikullovc Fatos Ukaj Lutfi Maxhuni
Kryeshefi Ekzekutiv	Fadil Ismajli
Sekretari i Kompanisë	Merita Kostari
Drejtori Financiar	Nebih Haziri
Auditori i Brendshëm	Shaqir Rexhepi

Tabela 11 - Të dhënat e përgjithshme të KOSTT-it

KOSTT është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, ku Kosova është anëtare me të drejta të barabarta.

I emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në bazë të dispozitave të legjislacionit parësor dhe dytësor të Kosovës, KOSTT sh.a në tetor të vitit 2006 u licencua si: Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Operator i Tregut të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë, KOSTT ka një pozicion strategjik në tregun rajonal ndërkombëtar të energjisë elektrike pasi që ndërlidhet me katër sisteme të tjera siç janë, ai i Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

KOSTT, si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST), është përgjegjës për operim efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe është përgjegjës për menaxhimin e rrjedhave të energjisë në linjat interkonjektive.

Ndërsa, KOSTT, si Operator i Tregut të energjisë elektrike, është gjithashtu përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike, si dhe për menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtar.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të sigurta dhe të besueshme për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, e integruar në mekanizmat evropianë të transmisionit të energjisë elektrike, duke qenë njëkohësisht edhe fitimprurëse.

Misioni

Misioni i KOSTT-it është që të sigurojë:

- Shërbime kualitative duke implementuar arritjet tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;

- Transparencë dhe jodiskriminim për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- Avancimi i pozitës së kompanisë në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shtuara në këtë drejtim.

Objektivat për të ardhmen

Objektivat e kësaj ndërmarrjeje kanë të bëjnë me sigurimin e saj si një organizatë efektive dhe e gatshme për t'u përballur me çdo sfidë të së ardhmes. Disa nga objektivat kyçe janë të radhitura si më poshtë:

- Të sigurojë zhvillimin efektiv të rrjetit të transmisionit;
- Të rris performancën e sistemit të transmisionit;
- Të avancojë planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të sistemit;
- Të sigurojë qëndrueshmëri financiare;
- Të jetë punëdhënës atraktiv, ambient për investim në zhvillimin profesional të punonjësve;
- Të vendosë marrëdhënie efektive me palët e interesit;
- Të anëtarësohet në ENTSO-e dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
- Të ketë pjesëmarrje aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal;
- Të sigurojë ambient të sigurt pune;
- Të jetë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor.

Projektet

Duke u bazuar në planin e tij zhvillimor, KOSTT ka bërë investime të shumta, të cilat kanë bërë të mundur përmirësimin e rrjetit të transmisionit. Financimi i këtyre projekteve ka qenë bashkëpunim i KOSTT me Qeverinë e Kosovës, me donatorë të ndryshëm si KfW, ECLO, apo me investime vetanake. Gjatë vitit 2011 disa projekte janë përfunduar, disa të tjera kanë filluar implementimin, ndërsa disa të tjera janë në proces e sipër, të cilat përfundojnë në vitet në vazhdim.

Disa nga projektet më të rëndësishme gjatë vitit 2011 janë të paraqitura më poshtë:

- Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 me Linjat Ndërlidhëse 400kv dhe 110 kV dhe shërbimet konsulentë, financuar nga KE dhe Buxheti i Kosovës;
- Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë – Shqipëri, financuar nga KfW;
- Shërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS dhe Telekom, financuar nga Buxheti i Kosovës);
- Paket-Projekti SCADA/EMS dhe Telekom LOT-1:SCADA/EMS, financuar nga Buxheti i Kosovës;
- LOT 1 dhe LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS Prishtina 4, financuar nga KOSTT;
- Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1), financuar nga KE;
- TI për Operimin e Tregut (LOT2), financuar nga ECLO;

- Ndërrimi i pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS ‘Kosova B’ ana 400 kV, financuar nga KOSTT;
- Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2), financuar nga KOSTT;
- Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3, financuar nga KOSTT;
- Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakovë 1 – Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga KOSTT;
- Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV, ‘Kosova B’, financuar nga KOSTT.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionale duke i krahasuar me vitin paraprak 2010 dhe buxhetin përkatës të vitit 2011. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor ka pasur një format tjetër nga raporti tremujore, mirëpo të dhënat janë pothuajse të njëjta, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Ndër shumë detyra të tjera, Bordi i Drejtorëve ka për detyrë edhe të formojë komisione të tjera duke u bazuar në nevojat që kompania paraqet. Bordi i KOSTT-it e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme të formojë këto komisione: Komisionin për Projekte Kapitale, Komisionin për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT dhe Komisionin për linjën 400kv Kosovë – Shqipëri. Gjatë vitit 2011, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 10 mbledhje, Komisioni i Auditimit ka mbajtur 8 mbledhje, ndërsa komisionet e tjera kanë mbajtur mbledhje varësisht nga nevoja që është paraqitur për t’i mbajtur ato. Gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së tij. Për këtë shih vlerësimin e NJPMNP, në raportin e publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	Humbjet në Transmision		Kapaciteti i Transformatorëve (MVA)	Kapaciteti i Linjës (MVA)	Numri i ankesave
	MWh	%			
2010	131.043	2.38	1500	1050	8
2011	115.315	2.06	1800	1350	2

Tabela 12- Performanca Operative e KOSTT-it

Tabela 12 tregon se investimet e ndërmarra gjatë viteve kanë arritur të zvogëlojnë humbjet në transmision nga viti në vit. Gjatë vitit 2011, humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 0.32 % më të vogla nga viti paraprak.


KOSTT ka kryer investime edhe tek transformatorët dhe e cila ka rezultuar në një rritje rreth 20% të performancës së transformatorëve, ose një rritje nga 1500 MVA në 2010 në 1800 MVA në 2011. Po ashtu, është kapaciteti i linjës është rritur nga 1050 në 1350 MVA, ose 28.57%.

Ankesat për tension në vitin 2010 kanë qenë 8, ndërsa gjatë vitit 2011 kanë ndodhur vetëm 2 ankesa për tension.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	18,792	22,725
Shpenzimet	-8,770	-11,626
Fitimi/Humbja operative	10,022	11,099
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-6,349	-4,866
Borxhet e këqija	-2,390	-2,765
Fitimi/Humbja financiare	1,283	3,468
Paraja në fund të vitit	18,605	14,850

Tabela 13 -Performanca Financiare e KOSTT-it



Grafiku 3 – Fitimi/Humbja Financiare, KOSTT



Grafiku 4 – Paraja ne fund te vitit, KOSTT

Siç shihet edhe në tabelë, KOSTT ka performuar me një afarizëm pozitiv gjatë vitit 2011. Në krahasim me vitin 2010, kjo shifër pozitive është më e vogël, mirëpo kjo ka ardhur si rezultat i

provizionimit të kërkesave, të cilat KEK refuzon t'i paguajë. Për më shumë, kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve dhe institucioneve të shtetit të Kosovës, e bën këtë kompani që të jetë një kompani financiarisht e qëndrueshme.

Vazhdimi i investimeve kapitale edhe gjatë vitit 2011 ka ranguar sistemin elektroenergjetik në një nivel të kënaqshëm të sigurisë dhe performancës dhe në këtë mënyrë ka arritur edhe rritja e vlerës së aseteve të KOSTT-it.

4.3 PTK

Emri i Kompanisë	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a. (PTK)
Numri i Regjistrimit	70280741
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	5,000,000 €
Drejtorët e Bordit	Rexhë Gjonbalaj (Kryesues) Qamil Buzhala Nuhi Ahmeti Elmaze Pireva Gani Sylaj Sahit Surdulli
Kryeshefi Ekzekutiv	Shyqyri Haxha
Sekretari i Kompanisë	Sebahedin Ramaxhiku
Drejtori Financiar	Nuredin Krasniqi
Auditori i Brendshëm	Genc Rraci

Tabela 14 - Të dhënat e përgjithshme të PTK-ës

Me 29 qershor të vitit 2005, PTK është korporatizuar dhe shndërruar në shoqëri aksionare, me emrin e ri PTK sh.a, e cila është e organizuar në tri njësi biznesi: Posta e Kosovës, Telekom i Kosovës dhe operatori i telefonisë mobile Vala. Të tri njësitë e biznesit të PTK-së janë të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës.

Operatori i telefonisë mobile Vala, ka shtrirë rrjetin e saj pothuajse në tërë territorin e Kosovës, dhe që një kohë të gjatë ofron për të gjithë konsumatorët e saj shërbimet më të avancuara të telefonisë mobile, brenda dhe jashtë operatorit Vala.

Telekomi i Kosovës ka shndërruar rrjetin e vet analog në atë të gjeneratës së ardhshme (NGN), duke mundur ofrimin e shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit (IPTV).

Posta e Kosovës, gjithashtu ka avancuar shërbimet e saj përmes automatizimit të sporteleve, në të cilat ofrohen produktet e të gjitha njësive të biznesit.

Viti 2011 është mbyllur me një mbulueshmëri gjeografike prej 84% nga ana e shërbimeve të telekomunikacionit. VALA ka përmirësuar roamingun me 350 rrjete në mbarë botën, në mbi 130 shtete. Por, objektiv mbetet shtrirja me GPRS në shtetet që vizitohen më shpesh nga konsumatorët tanë.

Fillimi i vitit 2011 karakterizohet me implementimin e shërbimit IPTV, duke krijuar mundësi që konsumatorëve t'u ofrojmë shërbimet triple-play respektivisht zërin, internetin dhe videon. Orientimi i Telekomit ka qenë ofrimi i pakove të përshtatshme për ambiente familjare. Në pajtim me këtë koncept kemi përpiluar edhe paketat e reja më të volitshme për konsumatorët.

Përkundër vështirësive me furnizime, janë ndërmarrë veprime në shtrirjen e kabllor optike për ndërlidhjen e pikave të prezencës me fije. Vitin 2011 e karakterizon edhe rritja e kërkesave për shërbime të internetit, sidomos në modifikimin e pakove, duke ua shtuar pakove të zërit edhe internetin.

Gjatë vitit 2011 janë hapur gjashtë zyra të reja postare, tani Posta e Kosovës përmes rrjetit të gjerë të zyrave të saj (155 ZP), krijoi kushte të favorshme për qytetarët e Kosovës gjatë realizimit të kërkesave të tyre për shërbimet dhe produktet e PTK-së, si në pjesët më të largëta rurale dhe në institucione arsimore.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të Postë-telekomunikimit përmes teknologjisë së avancuar, për konsumatorët e saj, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të PTK-së si pasuri e shtetit të Kosovës.

Misioni

Të jetë gjithmonë prijëse në ofrimin e shërbimeve superiore të komunikimit, që ua përmirësojnë jetën të gjithë kosovarëve, përmes profesionalitetit të të punësuarve dhe përmes përdorimit të teknologjisë më bashkëkohore të sprovuar.

Objektivat për të ardhmen

PTK në vazhdimësi para vetes ka përcaktuar objektivat e punës të fokusuar në zhvillimin dhe avancimin e produkteve, ose shërbimeve në përputhje me vizionin dhe misionin e saj, në mënyrë që planet për të ardhmen të jenë të suksesshme dhe të rezultojë pozitive. Mirëpo, objektivi parësor i PTK-së, vazhdon të mbetet konsumatori dhe përmbushja e kërkesave të tyre përmes ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të reja, ndërkohë që mbetet ende në fuqi plani i synuar për zgjerimin e kapaciteteve për konsumatorë të tjerë. Rritja e neto fitimit të PTK-së, zvogëlimi i shpenzimeve operative, si dhe shtimi i numrit të konsumatorëve, ka qenë dhe është orientim strategjik i menaxhmentit ekzekutiv të kompanisë.

Projektet

Projektet kryesore në TiK, të cilat janë realizuar përgjatë vitit 2011 janë:

- Projekti i Postës Hibride;
- Projekti i Automatizimit të Sporteleve të Postës;
- Sistemi i menaxhimit në distancë të BTS-lokacioneve;
- Lidhja e pikave kufitare me Kabllo Optike;
- Zgjerimi i infrastrukturës për vendosjen e pikave të reja të prezencës;
- Rritja e mbulueshmërisë 100% të territorit të banuar –Faza e VI;
- Sistemi i menaxhimit në distancë të BTS-lokacioneve;
- Shtrirja e kabllos optike në LS Veternik - PTK Hajvali -Llot 1;
- Punimi i kanalizimit dhe rrjetit telefonik me fibër optikë për Lagjen Suhodoll -Mitrovicë, faza e parë;
- Furnizim me ADSL Modema Llot 1;
- Furnizim me ADSL wireline Modems Llot 2.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të PTK-së.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2011. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë në çdo njësi të biznesit të saj, si dhe treguesit kyç që do të arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë. Sipas Statutit të PTK, e pasi PTK ka filluar procesin e privatizimit, është përcaktuar që aksionari ta shqyrtojë dhe miratojë Planin e Biznesit të dërguar nga bordi i drejtorëve. Kështu Aksionari, përmes Komisionit të Ministrave për NP në nëntor të 2011, ka sugjeruar që në Planin e Biznesit 2012, të ketë reduktim të kostove të pagave, ashtu që ky trend i shpenzimeve të mos kalojë 20-22% të të hyrave të përgjithshme, përderisa në vitin 2011 ishte 30.2%.

Raportet tremujore për tremujorin e parë dhe të dytë nuk janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe këto janë disa nga faktet që janë marrë edhe gjatë vlerësimit të efektshmërisë së punës së bordit si tërësi, edhe pse janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara ose të pezulluara, arritjet e divizioneve, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare, por nuk përmbush kërkesat e NJPMNP sipas udhëzuesit të dërguar.

Vlen për të theksuar se vonesa e hapave energjike të bordit mbi miratimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes korporatave ka qenë edhe një nga indikatorët që ka ndikuar në vlerësimin e punës së Bordit të PTK-së.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Aksionari mban përgjegjësinë e drejtimit të kompanisë në përputhje me politikat e Aksionarit dhe në përputhje me ligjin. Gjatë vitit 2011, Bordi ka mbajtur 16 takime, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Ndërsa, Komisioni i Auditimit ka mbajtur 9 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i drejtorëve ka formuar dhe disa komisione, siç janë: Komiteti për përcjellje të zbatimit/ekzekutiv të planeve kapitale dhe ekzekutimit të BP, Komiteti për përcjellje të zhvillimit të shërbimeve të reja të marketingut dhe kënaqësisë së konsumatorëve, Komisioni për përcjellje të Qeverisjes Korporative dhe pajtueshmërisë dhe Komiteti për Resurse Njerëzore dhe Kompensim. Këto komitete kishin një aktivitet jo të mjaftueshëm të funksionimit dhe NJPMNP në 2012 ka kërkuar që të rishikohet nevoja e funksionimit të tyre.

Duke marrë për bazë të lartpërmendurat, Njësia ka bërë vlerësim e efektshmërisë së bordit dhe ky raport është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	Telefonia Fikse (Telekomi)		Telefonia Mobile (Vala)		Interneti	
	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)	Numri i konsumatorëve	Mbulueshmëria e tregut (%)
2010	82,805	93.7	1,018,400	70.15	42,981	34
2011	82,238	94.4	992,963	67.14	36,427	25.43


Tabela 15 - Performanca Operative e PTK

Të dhënat nga Tabela 15. janë të koordinuara me raportin e ART-ës dhe nga kjo shihet se treguesit operativë nuk kënaqin, pasi kemi një rënie të numrit të klientëve në telefoninë fikse, kemi po ashtu rënie të numrit të konsumatorëve edhe tek Vala, që njëjtë paraqitet edhe tek interneti. Progres shihet vetëm tek mbulueshmëria e tregut të Telekomi me një rritje prej 0.7% nga viti paraprak.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	164,297	154,049
Shpenzimet	-94,156	-95,960
Fitimi/Humbja operative	70,141	58,089
Zhvlërimi dhe amortizimi	-24,025	-24,693
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	46,116	33,396
Paraja në fund të vitit	32,804	45,195

Tabela 16 - Performanca Financiare e PTK



Grafiku 5 – Fitimi/Humbja Financiare, PTK



Grafiku 6 – Paraja ne fund te vitit, PTK

Tabela 16 tregon se të hyrat operative të PTK, sh.a. gjatë vitit 2011 kanë shënuar rritje prej 6.6% nga viti paraprak dhe një zvogëlim të shpenzimeve për 2%, gjë që ka sjellë edhe një fitim financiar vjetor më të madh se viti paraprak për 38%.

4.4 ANP

Emri i Kompanisë	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, sh.a. (ANP)
Numri i Regjistrimit	70280980
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Bekim Jashari (Kryesues) Naser Canolli Fejzullah Krasniqi Besnik Krasniqi Bislim Zogaj Hanefi Muharremi
Kryeshefi Ekzekutiv	U.D Bahri Nuredini
Sekretari i Kompanisë	U.D Njomza Gashi
Drejtori Financiar	Valon Grabovci
Auditori i Brendshëm	Fetije Uka ¹³

Tabela 17 - Të dhënat e përgjithshme të ANP-ës

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kontrolli Ajror, është një ndërmarrje publike, veprimtaria e së cilës bazohet në qarkullimin civil dhe në qarkullimin ushtarak. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”-Kontrolli Ajror, mundëson fluturimet prej Kosovës në shumë vende të botës dhe anasjelltas për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shteteve tjera.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”-Kontrolli Ajror është aset strategjik publik me rëndësi shumë të madhe për qytetarët e Kosovës dhe për zhvillimin e shtetit.

Viti 2011 për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”-Kontrolli Ajror, mund të konsiderohet si vit i transferit nga ndërmarrje publike në Partneritetin Publiko-Privat. Kjo pasi që në prill të 2011 ka kaluar në Operim nga Operatori –fituesi i kontratës së PPP-konzorciumi turko – francez: Limak - Aeroports de Lyon.

Vlen të theksohet se jashtë kontratës së koncesionimit ka mbetur pjesa e kullës dhe kontrollit ajror, e cila është në pronësi të Qeverisë dhe funksionon normalisht si ndërmarrje publike.

Vizioni

Certifikimi ndërkombëtar si ofrues i Shërbimeve të Navigimit Ajror, sipas kërkesave të paraqitura nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës konform standardeve ndërkombëtare të Eurocontrol dhe ICAO.

Misioni

Misioni i ANP “Adem Jashari” është të sigurojë shërbime cilësore në përputhje me standardet ndërkombëtare të trafikut ajror dhe Sigurimin e fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës me cilësi të lartë, që nuk cenojnë mjedisin, si dhe të kontribuojë në kërkesën e Sigurisë së lartë në hapësirën ajrore të Kosovës.

¹³ Ka ushtruar kete pozite deri para koncesionimit te ANP

Objektivat për të ardhmen

- Certifikimi si Agjenci e Shërbimeve të Navigimit Ajror;
- Koordinimi i komponentëve të ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror, për të ofruar shërbim efektiv të Kontrollit të Trafikut Ajror, Shërbimeve të Survejimit, Komunikimit, Navigimit, Informacionit Aeronautik dhe Meteorologjisë;
- Menaxhimi efektiv i faktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;
- Hapja e hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës;
- Krijimi i një stabiliteti në burimet njerëzore me fokus në numrin dhe cilësinë e kontrollorëve të trafikut ajror;
- Kontroll financiar mbi ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, për të siguruar që kostoja të përdoret në mënyrë eficiente dhe efektive.

Projektet

Burimet e financimeve janë mbuluar nga të hyrat e ANP “Adem Jashari”.

Ka pasur projekte të mëdha që janë iniciuar gjatë vitit 2011. Shumica e projekteve janë rezultat i rilokimit të Radar-it (PSSR/MSSR), DVOR/DME të tanishëm. Si rezultat të këtyre ndryshimeve të paraqitura është iniciuar procesi i prokurimit të pajisjeve të reja, e cila në mes tjerash do të përfshijë MODE-S SSR të ri dhe VOR/DME të ri. Këto ndryshime të mëdha do të duhet të mbështeten me ndryshimet në procedurat ekzistuese dhe me prezantimin e procedurave të reja për t’u kujdesur për këto pajisje të reja.

- Shkollimi i Kontrollorëve të rinj të Trafikut Ajror, për periudhë 3 vjeçare;
- Furnizimi dhe instalimi me pajisje për ATIS;
- Blerja dhe implementimi i aplikacionit financiar.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të ANP-së.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2011. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi, po ashtu me vonesë nga afatet e parapara ligjore dhe këto janë disa nga faktet që janë marrë edhe gjatë vlerësimit të efektshmërisë së punës së bordit si tërësi, edhe pse janë aprovuar më kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Aksionari mban përgjegjësinë e drejtimit të kompanisë në përputhje me politikat e Aksionarit dhe në përputhje me ligjin. Gjatë vitit 2011, Bordi ka mbajtur 11 takime, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komitete të tjera, të cilët nuk kanë pasur aktivitete të dëndur. Këto komitete janë: Komisioni për Burime Njerëzore, Komisioni për Përgatitjen dhe Ndarjen e DOSHNA-së dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Projekteve Kapitale.


Njësia, në përputhje me faktet e lartcekura, ka vlerësuar efektshmërinë e punës së bordit dhe ky vlerësim është publikuar në ueb faqen e MZHE-së.

Performanca Financiare


	2011 (000€)
Të hyrat	8,958
Shpenzimet	-6,874
Fitimi/Humbja operative	2,084
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,688
Borxhet e këqija	0
Fitimi/Humbja financiare	396
Paraja në fund të vitit	6,015

Tabela 18 - Performanca Financiare e ANP

Krahasimi i të dhënave mes dy viteve kalendarike pothuajse nuk ka ndonjë kuptim, pasi në vitin 2011 pas muajit prill, pjesa e mbetur ka pësuar ndryshime në funksion, asete e staf, të cilat drejtpërdrejt kanë ndikuar në indikatorët financiarë nga viti 2010 në 396 mijë euro fitim financiar në 2011.



Grafiku 7 – Fitimi/Humbja Financiare, ANP



Grafiku 8 – Paraja ne fund te vitit, ANP

4.5 Hekurudhat e Kosovës

(01.01.2011 – 31.08.2011)

Emri i Kompanisë	Hekurudhat e Kosovës, sh.a. (HK)
Numri i Regjistrimit	70325327
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Sejdi Hoxha (Kryesues) Halim Peci Hysen Fazliu Halil Kika Fadil Krasniqi
Kryeshefi Ekzekutiv	U.D Xhevat Ramosaj
Sekretari i Kompanisë	Ruzhdi Morina
Drejtori Financiar	U.D Sefedin Sefaj
Auditori i Brendshëm	Avni Murati

Tabela 19 - Të dhënat e përgjithshme të HK

Hekurudhat e Kosovës, si e vetmja ndërmarrje e licencuar për ofrimin e shërbimeve të komunikacionit hekurudhor për transport të qytetareve dhe të mallrave ka 333,451 km të linjave hekurudhore të hapura, 105,784 km të linjave stacionare dhe 03 km të linjave industriale. Rrjeti i saj ka 23 tunele, me gjatësi totale prej 9,020 metra dhe 155 ura me gjatësi totale prej 2,9 km. Megjithatë, infrastruktura është e vjetër dhe ka nevojë për investime rinovuese. Në vitin 1999 sistemi hekurudhor, në vijim të viteve të investimeve të ulëta dhe periudhës së luftës, pothuajse kishte pushuar funksionimin.

Me përkrahjen e donatorëve të ndryshëm dhe Qeverisë, HK-ja ka arritur ta riparojë shumicën e infrastrukturës së saj dhe të gjitha linjat janë operative përveç dy linjave, Xërxë- Prizren (27km) dhe Prishtinë – Podujevë (37km). Sot HK operon me 6 shërbime ditore për udhëtarë:

- Liria e Lëvizjes së Trenit (Fushë Kosovë - Shkup dhe anasjelltas, edhe pse deri në Mars të vitit 2008 kjo ka vepruar deri në Leshak). Ky shërbim dy herë në ditë është plotësisht i subvencionuar nga Ministria e Infrastrukturës.
- Prishtinë- Pejë- Prishtinë dy herë në ditë; dhe
- Shërbimet e lëvruara nga HK janë si më poshtë:
 - Transporti konvencional i mallrave;
 - Transporti me kontejnerë;
 - Transporti i udhëtarëve;
 - Mirëmbajtja e vagonëve.

Në këtë kuadër është përgatitur edhe Strategjia Qeveritare për Modelin e Transportit, e aprovuar në Nëntor të vitit 2009, e cila tregon të ardhmen e HK-së deri në vitin 2030. Kjo përfshin planin për ndarjen e infrastrukturës hekurudhore, e cila tanimë është në realizim e sipër dhe pritet t'i inkurajojë operatorët privatë.

Investimet kapitale do të kërkohen për t'u realizuar ky plan, pasi vlerësohet se rreth 252 km të rrjetit hekurudhor të tanishme (Linja 10) kanë nevojë për investim. Të gjitha këto linja hekurudhore janë njëbinarëshe dhe të paelektifikuara.

Kjo Kompani ka funksionuar deri me 31 gusht 2011, prej së cilës janë formuar InfraKos sh.a dhe TrainKos sh.a.

Vizioni

Ofrimi i shërbimeve të transportit hekurudhor sa më cilësorë, me siguri të lartë dhe çmime konkurrencte, duke shfrytëzuar infrastrukturën hekurudhore me qëllim të realizimit të transportit të mallrave dhe udhëtarëve, sipas standardeve evropiane.

Misioni

Për ta ofruar një transport dhe shërbime hekurudhore konkurruese, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

Objektivat për të ardhmen

Që të arrihet niveli i dëshiruar i mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, në vijim janë paraqitur objektivat tona për vitet në vijim:

- Ofrimi i qasjes në 333 km të linjave hekurudhore sipas kërkesave të reja të lëvizshmërisë së udhëtarëve dhe mallrave, në mënyrë që të ofrohen shërbime të sigurt të transportit, të besueshme, më atraktive dhe të arsyeshme nga kompanitë e operimit me tren;
- Optimizmi i shfrytëzimit të aseteve të infrastrukturës;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare për infrastrukturën hekurudhore të Kosovës;
- Zhvillimi i mundshëm i infrastrukturës së re hekurudhore në të ardhmen, e cila do të jetë e nevojshme për t'i bërë ballë nevojave afatgjata të vendit për lëvizshmëri në të ardhmen;
- Ofrimi me kohë dhe korrekt i të gjitha shërbimeve ndaj operatorëve të transportit për qasjen në rrjetin hekurudhor;
- Menaxhimi me sukses i patundshmërisë dhe ngritja e inkasimit të të hyrave;
- Ngritja e nivelit të mirëmbajtjes së linjave hekurudhore dhe binarëve industrialë;
- Ngritja e sigurisë së përgjithshme në komunikacionin hekurudhor;
- Ngritja profesionale dhe ripërtëritja e stafit.

Projektet

Sikurse edhe vitet e kaluara, edhe në vitin 2011 Hekurudhat e Kosovës sh.a. kanë realizuar një numër të caktuar të projekteve zhvillimore të financuara nga Buxheti i Kosovës. Në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës bëjnë pjesë këto projekte:

- Riparimi i lokomotivave;
- Riparimi vagonëve të udhëtarëve;
- Riparimi i Tunelit Gajre; dhe

- Furnizimi me pjesë të infrastrukturës.

Nga shumë projekte të realizuara nga buxheti i HK-së, ne do të veçonim disa prej tyre, të cilat kanë pasur një kosto më të madhe:

- Furnizimi me dizel agregat të stacioneve në linjën e 10-të hekurudhore;
- Riparimi i motorëve tërheqës në lokomotivën 004 dhe 007, dhe ndërimi i rrotave në lokomotivën 009;
- Furnizimi me vajra dhe lubrifikantë;
- Furnizimi me balast për linjat hekurudhore;
- Furnizimi me kablllo të tensionit të lartë për nyjën e Fushë Kosovës.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë periudhës 01.01 deri me 31.08.2011, deri kur edhe funksionoi. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të jashtëm dhe Raporti mbi kënaqshmërinë e konsumatorit.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare, Performanca Operative.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës dhe detyrë prioritare e tij është ushtrimi i mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe rigorozë të veprimtarisë së zyrtareve të ndërmarrjes. Bordi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 8 takime. Po ashtu, ky organ ka formuar Komitetin për Investime Kapitale, Komitetin për Resurse Njerëzore dhe Komitetin për Siguri në Komunikacion.

NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së bordit të drejtorëve, i cili me punën e tij ka ndikuar që kompania të ketë një vazhdimësi në funksionim, dhe ky vlerësim është i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	1 Janar 2011 – 31 Gusht 2011	31 Dhjetor 2010
Transporti i mallrave (ton)	675,114	1,128,658
Numri i kontejnerëve në terminal	644	492
Numri i udhëtarëve	249,033	376,770

Tabela 20 - Performanca Operative e HK

Siç mund të shihet nga tabela 20, kemi një ngritje prej 31.16% të numrit të kontejnerëve dhe natyrisht një arritje tetë mujore të numrit të udhëtarëve dhe të transportit të mallrave.

Mosarritja e realizimit të vitit 2010 ka ardhur si rrjedhojë e sasive të reduktuara nga klientët kryesorë si: kompania “New Co Ferronikeli” me minus 83,212 tonë dhe “Standard Plin” me minus 8,821 tonë. Sipas deklarimeve të këtyre klientëve, në mosrealizimin e transportit për këtë periudhë kanë ndikuar disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, por që nuk janë të ndërlidhur dhe nuk varen nga HK.

Performanca Financiare

	1 Janar 2011 – 31 Gusht 2011 (000€)	31 Dhjetor 2010 (000€)
Të hyrat	5,896	7,927
Shpenzimet	-6,391	-4,982
Fitimi/Humbja operative	-495	2,945
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,749	-2,515
Borxhet e këqija	-56	-497
Fitimi/Humbja financiare	-2,300	-65
Paraja në fund të vitit	779	2,872

Tabela 21 - Performanca Financiare e HK

Edhe këta tregues nuk korrespondojnë me periudha të njëjta kohore krahasuese mes dy vitesh, pasi për vitin 2011 mungon koha e funksionimit katër mujor dhe zvogëlim i të hyrave prej 2.1 milionë eurosh që ndikon edhe në rezultatin financiar tetë mujor.

4.6 Hekurudhat e Kosovës – Infrakos

(01.09.2011 – 31.12.2011)

Emri i Kompanisë	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Infrakos)
Numri i Regjistrimit	70325327
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Sejdi Hoxha (Kryesues) Halim Peci Hysen Fazliu Halil Kika Fadil Krasniqi
Kryeshefi Ekzekutiv	Agron Thaqi
Sekretari i Kompanisë	Refet Citaku
Drejtori Financiar	Zymer Zekaj
Auditori i Brendshëm	Avni Murati

Tabela 22 - Të dhënat e përgjithshme të Infrakos-it

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës sh.a. - INFRAKOS është krijuar në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a. në dy kompani të reja:

- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës sh.a. (INFRAKOS); dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës sh.a. (TRAINKOS).

INFRAKOS, si kompani e cila veprimtari kryesore e ka biznesin e ofrimit të shërbimeve të infrastrukturës për ndërmarrjet transportuese hekurudhore, ka filluar të veprojë si kompani në vete që nga data 01.09.2011.

INFRAKOS si njëra ndër pasueset e Hekurudhave të Kosovës sh.a, në tërësi është një kompani publike në pronësi të shtetit dhe si e tillë ofron shërbime infrastrukturore hekurudhore.

INFRAKOS menaxhon 333,451 km të linjave të hapura ekzistuese hekurudhore, 105,784 km linja nëpër stacione dhe 103,4 km linja industriale. Të gjitha këto linja hekurudhore janë njëbinarëshe dhe të paelektrofikuara. INFRAKOS, mirëmban binarët, sistemet sinjalizuese, sistemet komunikuese, si dhe 34 stacione, 115 ura, 23 tunele dhe ndërtesat e tjera.

Vizioni

Ofrimi i Shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore sa më cilësore, me siguri të lartë dhe çmime konkurrencte, duke shfrytëzuar dhe mundësuar operatorit, realizim të transportit të mallrave dhe udhëtarëve sipas standardeve evropiane.

Misioni

Për të ofruar një infrastrukturë hekurudhore konkurruese, të qëndrueshme dhe të suksesshme në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

Objektivat për të ardhmen

Që të arrihet niveli i dëshiruar i mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, në vijim janë paraqitur objektivat tona për vitet në vijim:

- Ofrimi i qasjes në 333 km të linjave hekurudhore sipas kërkesave të reja të lëvizshmërisë së udhëtarëve dhe mallrave, në mënyrë që të ofrohen shërbime të sigurt të transportit, të besueshme, më atraktive dhe të arsyeshme nga kompanitë e operimit me tren;
- Optimizimi i shfrytëzimit të aseteve të infrastrukturës;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare për infrastrukturën hekurudhore të Kosovës;
- Zhvillimi i mundshëm i infrastrukturës së re hekurudhore në të ardhmen, e cila do të jetë e nevojshme për t'i bërë ballë nevojave afatgjata të vendit për lëvizshmëri në të ardhmen;
- Ofrimi me kohë dhe korrekt i të gjitha shërbimeve ndaj operatorëve të transportit për qasjen në rrjetin hekurudhor;
- Menaxhimi me sukses i patundshmërisë dhe ngritja e inkasimit të të hyrave;
- Ngritja e nivelit të mirëmbajtjes së linjave hekurudhore dhe binarëve industrialë;
- Ngritja e sigurisë së përgjithshme në komunikacionin hekurudhor.

Projektet

Sikurse edhe vitet e kaluara, edhe në vitin 2011 InfraKos, sh.a. si kompani e re kanë realizuar një numër të caktuar të projekteve zhvillimore të financuara nga Buxheti i Kosovës, projekte këto të bartura nga Kompania amë, ish Hekurudhat e Kosovës. Në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës bëjnë pjesë këto projekte:

- Riparimi i Tunelit Gajre; dhe
- Furnizimi me pjesë të infrastrukturës.

Nga shumë projekte të realizuara nga buxheti i HK-së, ne do të veçonim disa prej tyre, të cilat kanë pasur një kosto më të madhe:

- Furnizimi me balast për linjat hekurudhore;
- Furnizimi me kablllo të tensionit të lartë për nyjën e Fushë Kosovës.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të InfraKos sh.a.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë periudhës 01.09-31.12.2011, kur edhe filloi të funksionojë. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raporti i tremujorit të katërt, së bashku me Raportin Vjetor janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Raporti mbi kënaqshmërinë e Konsumatorit.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës si vazhdimësi nga Bordi i Hekurudhave të Kosovës, dhe po ky bord ka vazhduar punën. Bordi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 5 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 4 takime. Po ashtu, ky organ ka miratuar vazhdimin e punës për Komitetin për Investime Kapitale, Komitetin për Resurse Njerëzore dhe Komitetin për Siguri në Komunikacion.

NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së Bordit të Drejtorëve, i cili me punën e tij ka ndikuar që kompania të ketë një vazhdimësi në funksionim. Shih për këtë vlerësimin e NJPMNP për punën katër mujore mbi këtë bord të publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Financiare

	1 Shtator 2011 – 31 Dhjetor 2011 (000€)
Të hyrat	1,337
Shpenzimet	-1,056
Fitimi/Humbja operative	281
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-364
Borxhet e këqija	0
Fitimi/Humbja financiare	-83
Paraja në fund të vitit	423

Tabela 23 - Performanca Financiare e Infracos-it

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shihet se të dhënat janë vetëm për funksionim katërmujor nga rezulton se InfraKos ka një humbje prej 83 mijë euro.

4.7 Trainkos

(01.09.2011 – 31.12.2011)

Emri i Kompanisë	Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Trainkos)
Numri i Regjistrimit	70773120
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Hasan Ibraj (Kryesues) Heset Cakolli Labinot Halilaj Shkumbin Hyseni
Kryeshefi Ekzekutiv	Ruzhdi Morina
Sekretari i Kompanisë	Afrim Kuleta
Drejtori Financiar	Zair Imeri
Auditori i Brendshëm	Remzi Jashari

Tabela 24 - Të dhënat e përgjithshme të Trainkos-it

Me vendim të Qeverisë është bërë ndarja ligjore e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani të reja: INFRAKOS sh.a (Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës) dhe TRAINKOS sh.a (Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës).

Me realizimin e kësaj ndarje dhe me punën e treguar nga TRAINKOS, sh.a, në drejtim të përafrimit dhe kompletimit të infrastrukturës ligjore, kjo kompani është duke operuar dhe performuar suksesshëm dhe si një kompani e re e themeluar në shtator të viti 2011 ka filluar punën e vet me një staf të pakompletuar tërësisht, por ka pasur sukses që të arrijë të përmbushë pritjet më optimiste për katër mujorin e viti 2011.

Kompletimi i stafit dhe realizimi i parashikimeve për vitin 2012 janë sfida për vazhdimin e punës me sukses dhe arritjes së qëllimit për një performancë pozitive.

Vizioni

Ofrimi i shërbimeve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve sa me cilësor, me siguri të lartë dhe çmime konkurrencte duke shfrytëzuar infrastrukturën hekurudhore sipas standardeve evropiane.

Misioni

Për të ofruar një transport të mallrave dhe udhëtarëve me çmime konkurruese, të qëndrueshëm dhe në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike. Kjo mund të arrihet me qëndrueshmëri financiare dhe ngritje të vazhdueshme, ku puna jonë të jetë burim i vazhdueshëm i besueshmërisë së klientëve tanë dhe krenarisë për ne.

Objektivat për të ardhmen

- Objektiv i në tregun e transportit të udhëtarëve është një transport i sigurt dhe komod;
- Objektiv i në tregun e mirëmbajtjes së vagonëve është që të kemi një rritje prej 5%;

- Objektiv tjetër është që niveli i inkasimit të mjeteve të faturuara të mbahet mbi nivelin 85%; Ndërsa, niveli i inkasimit të borxheve (arkëtueshme) të mëparshme të jetë mbi 40%;
- Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- Përmirësimi i gjendjes së parkut lëvizës karshi plotësimit të nevojave operative për mjete lëvizëse.

Projektet

Trainkos sh.a. ka trashëguar disa projekte nga ish-Hekurudhat e Kosovës, të cilat janë në faza të ndryshme të zbatimit. Po ashtu, sipas buxhetit të aprovuar pas themelimit të Trainkos sh.a, Menaxhmenti ka iniciuar disa projekte të tjera me vlera të ndryshme, të cilat gjithashtu janë në faza të ndryshme të realizimit. Më poshtë do të paraqesim disa nga projektet kryesore kapitale të realizuara gjatë vitit 2011, të cilat janë financuar nga Buxheti i Kosovës dhe vlerën e projekteve të financuara nga buxheti operativ i kompanisë.

Nga Buxheti i Kosovës janë financuar projekte kapitale për mjete lëvizëse;

- Riparimi i mesëm i vagonëve të udhëtarëve – Financuar nga Buxheti i Kosovës;
- Riparimi gjeneral i lokomotivës 645-033 - Financuar nga Buxheti i Kosovës;
- Pajisje për lokomotivë dhe vagonë dhe projekte tjera-Financuar nga Buxheti i Kosovës.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të TrainKos, sh.a.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë periudhës 01.09-31.12.2011, kur edhe filloi të funksionojë.

Raporti i tremujorit të katërt, se bashku me raportin vjetor janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar më kohë edhe Raporti i Auditorit të jashtëm.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës me Vendim. Bordi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 3 takime.

Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komisione janë: Komisioni për Hulumtime dhe Teknologji, Komisioni për Financa, dhe Komisioni për Staf dhe Shpërblime.

NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së Bordit të Drejtorëve, i cili me punën e tij ka ndikuar që kompania të ketë një vazhdimësi në funksionim të operimit me trenat. Shih për këtë vlerësimin e NJPMNP të publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca operative

Indikatorët Operativë	1 Shtator 2011 – 31 Dhjetor 2011
Transporti i mallrave (ton)	358,170
Numri i udhëtarëve	108,692

Tabela 25 - Performanca Operative e Trainkos-it

Siç mund të shihet në tabelën 25, për këtë periudhë katërmujore në fushën e biznesit të transportit të mallrave, e cila ka rëndësinë kryesore për këtë kompani, kanë arritur të transportojnë sasinë prej 358 mijë tonë dhe të sigurojnë transport për 108.6 mijë udhëtarë.

Performanca Financiare

	1 Shtator 2011 – 31 Dhjetor 2011 (000€)
Të hyrat	2,364
Shpenzimet	-1,588
Fitimi/Humbja operative	776
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-428
Borxhet e këqija	0
Fitimi/Humbja financiare	348
Paraja në fund të vitit	420

Tabela 26 - Performanca Financiare e Trainkos-it

Për periudhën shtator-dhjetor 2011, kjo kompani ka arritur një fitim financiar prej 348 mijë eurosh që është rezultat i të hyrave prej 2.3 milionë euro dhe shpenzimeve prej 1.58 milionë euro, nga të cilat vetëm shpenzime të zhvlerësimit ishin 428 mijë euro.

4.8 KRU Prishtina

Emri i Kompanisë	KRU Prishtina, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433736
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Ejup Hashani (Kryesues) Adem Duriqi Bajram Jashari Kujtim Xhelili
Kryeshefi Ekzekutiv	Gjelosh Vataj ¹⁴
Sekretari i Kompanisë	Enes Mehmeti
Drejtori Financiar	Selatin Retkoceri ¹⁵
Auditori i Brendshëm	Gjelosh Gojani

Tabela 27 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Prishtina

Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Prishtina” është ndërmarrja më e madhe ujit në Kosovë. Mbulueshmëria me shërbimet e ujit të pijes arrin në 90% dhe me shërbime të ujërave të zeza me rreth 79% të popullatës së regjionit ku KRU shërben. Kompania Ujësjellësi Rajonal (KUR) “Prishtina” sh.a, shërbimet e veta i ofron në pjesën qendrore të Kosovës, duke i përfshirë këto komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Drenas, Podujevë dhe Graçanicë.

Numri i popullatës së shërbyer në zonën që operon KUR “Prishtina” sh.a. vlerësohet rreth 450.000 banorë. Kapaciteti momental prodhues (i mundshëm nën supozimin e ekzistimit të rezervave të mjaftueshme të burimeve të ujit në liqenet akumuluese) sillet rreth $Q=1400$ l/s ose minimalisht 43.000.000 deri 45.000.000 m³ në vit.

KUR “Prishtina” sh.a. i posedon dy fabrika për trajtimin e ujit të alokuara në Albanik dhe në Badovc. Në këto fabrika uji fillestar merret nga liqenet artificiale akumuluese; Batllavë dhe Badovc.

Vizioni

Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit, me çmime sa më të favorshme dhe më ujë cilësor dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Misioni

Konsumatori në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim: Pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përmbushur këtë “mision” do të bëhet e mundur sigurimi i vetqëndrushmërisë me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe një kompani publike, të qëndrueshme financiarisht dhe të gatshme të ballafaqohet me sfidat.

¹⁴ Gjelosh Vataj u zgjodh KE në Nëntor 2011 pas dorëheqjes së Skender Bublaku në Qershor. Deri në Nëntor, Gjelosh Vataj ushtroi këtë detyrë si U.D.

¹⁵ Selatin Ratkoceri u zgjodh Zyrtar Kryesor Financiar në Nëntor 2011, pas dorëheqjes së Naim Mujaj.

Objektivat për të ardhmen

- Rritja e shkallës së arkëtimit në total dhe atë: në vitin 2012 në shkallën mesatare 73%, në vitin 2013 përafërsisht në shkallën mesatare 78%, në vitin 2014 në shkallën mesatare rreth 79%, në vitin 2015 në shkallën mesatare rreth 80%, për të arritur në shkallën optimale mesatare rreth 84% në fund të vitit 2016.
- Humbjet teknike dhe komerciale të ujit, përkatësisht uji i pafaturuar do të ketë tendencë të rënies në këto shkallë: 49% në vitin 2012, 47% në vitin 2013, 44% në vitin 2014, 41% në vitin 2015 dhe në vitin 2016 përafërsisht humbjet teknike do të sillen rreth 38%.
- Brenda periudhës 2012-2016 do të bëhet projeksioni i bilancit të ujit të pijes dhe ujërave të ndotura, si dhe fillimi i zbatimit të Planit Strategjik Zhvillimor Afatgjatë 2015-2040 për regjionin që mbulon KUR “Prishtina” sh.a. Përpilimi i këtyre dy dokumenteve shumë të rëndësishme do të bëhet në bazë të partneritetit të vazhdueshëm me Konsulencën që ka zgjedhur Banka Gjermane për Zhvillim.
- Në bashkëpunim me ministrinë dhe komunat, forcimi i aktiviteteve për mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore që shfrytëzohen si burime të ujit të pijes nga KUR “Prishtina” sh.a. marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.
- Plani është përgatitur duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë, si dhe jashtë Kosovës për të adoptuar praktikat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë. Por, gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në Republikën e Kosovës.

Projektet

- Fabrika e ujit në Shkabaj, si bashkëfinansim mes KFW, KE, Qeverisë së Kosovës dhe Komunes së Prishtinës (në fazën fillestare);
- Vazhdimi i implementimit teknik (në terren) të projektit të gypit kryesor magjstral Mirditë-Park, të financuar nga Komisioni Evropian;
- Ndërrimi i rrjetit të gypave të ujësjellësit në Prishtinë, projekt i financuar nga KfW;
- Mbështetja e sistemit të ujësjellësit në Lipjan dhe Drenas, financuar nga USAID, KUR “Prishtina” sh.a dhe komunat Lipjan, përkatësisht Drenas;
- Rritja e kapaciteteve prodhuese – përpunuese të sistemit të ujësjellësit në Fushë Kosovë, financuar nga KRU ‘Prishtina’, MTI dhe Komuna e Fushe Kosovës;
- Rritjen e numrit të konsumatorëve të amvisërisë dhe bizneseve. Projekti arrin vlerën rreth 1.400.000 €.
- Studimi i fizibilitetit për burime të reja për regjionin e Prishtinës, financuar nga Komisioni Evropian.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU ‘Prishtina’.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2011. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë t'i realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të Kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ka dërguar NJPMNP, për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2011, (14 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse para çdo mbledhjeje të Bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 14 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar edhe disa komisione të tjera të cilët nuk kanë pasur ndonjë aktivitet që vlen për tu theksuar. Këto komisione janë: Komisioni për Investime Kapitale, Komisioni për Financa, Komisioni për Staf dhe Shpërblime, Komisioni për Hulumtime dhe Teknologji, dhe Komisioni për Menaxhimin e Rrezikut.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësim e efektshmërisë së tij. Për këtë shih vlerësimin e NJPMNP të publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	45,940,658	45,606,153
Faturimi i ujit (%)	46	45
Inkasimi i ujit (%)	70	70
Uji i pafaturuar (%)	54	55
Testet e dështuara të ujit (%)	1.9	0.8
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	84	83
Numri i konsumatorëve	99,216	92,525


Tabela 28 - Performanca Operative e KRU Prishtina

Nga tabela 28 shihen treguesit progresivë në krahasim me vitin paraprak tek prodhimi i ujit, faturimi i ujit, humbja e ujit dhe tek rritja e numrit të konsumatorëve. Ndërsa, tek kualiteti i ujit kemi një rënie, por prapë mund të themi që është në kuadër të limiteve të lejueshme për testet e dështuara të ujit, e cila është deri në 3%.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	12,941	11,611
Shpenzimet	-7,661	-6,415
Fitimi/Humbja operative	5,280	5,196
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-3,960	-3,846
Borxhet e këqija	-1,644	-3,289
Fitimi/Humbja financiare	-324	-1,939
Paraja në fund të vitit	1,614	1,251

Tabela 29 - Performanca Financiare e KRU Prishtina



Grafiku 9 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Prishtina



Grafiku 10 – Paraja ne fund te vitit, KRU Prishtina

Tabela 29, pasqyron që KRU ‘Prishtina’ vitin 2011 e ka përmbyllur me një humbje më të vogël për 83% nga viti paraprak dhe kjo vjen ngase janë rritur të hyrat, si dhe janë zvogëluar shpenzimet e borxheve të këqija.

4.9 KRU Radoniqi

Emri i Kompanisë	KRU Radoniqi, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433554
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Ruzhdi Këpuska (Kryesues) ¹⁶ Leonard Shehu (U.D Kryesues) ¹⁷ Hajdar Grezda Agim Gjoshi ¹⁸
Kryeshefi Ekzekutiv	Ismet Ahmeti ¹⁹
Sekretari i Kompanisë	Saranda Vehapi
Drejtori Financiar	Kastriot Zhaveli
Auditori i Brendshëm	Mehmet Shehu

Tabela 30 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Radoniqi

Ndërmarrja KRU ‘Radoniqi’, sh.a. merret me prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm dhe për largimin e ujërave të zeza për regjionin Gjakovë, Rahovec dhe një pjesë të komunës së Prizrenit. Kompania rajonale e ujësjellësit KRU ‘Radoniqi’, në fund të vitit 2011 kishte 28.859 konsumatorë, apo 3% më shumë se në vitin paraprak dhe kështu mbulon territorin me rreth 230.000 banorë, të cilët përfshihen në këto shërbime. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit është nën menaxhimin e KRU ‘Radoniqi’ me selinë në Gjakovë, me shtrirje gjeografike Jugperëndim të Kosovës, në pronësi të Republikës së Kosovës, nën monitorimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ZRRUM-i si rregullator dhe udhëzues i kompanive ujore, e po ashtu edhe me mbikëqyrjen nga Bordi i Drejtorëve. Furnizimi me ujë bëhet nga liqeni i Radoniqit. Kapaciteti për fazën e parë është projektuar për 500 l/sec, ndërsa aktualisht prodhimi arrin edhe deri në 730 l/sec.

KRU ‘Radoniqi’ sh.a. rrjetin e vet e shtrinë prej fshatit Skivjan deri në fshatin Zym, me rreth 220.000 banorë, që përfshin Komunën e Gjakovës me 41 fshatra, dhe Komunën e Rahovecit me 8 fshatra, si dhe 13 fshatra të Komunës së Prizrenit, me një prodhim vjetor për vitin 2011 – 20.377.470 m³. Kurse, aktivitetin për ujërat e zeza që janë inkorporuar gjatë vitit 2006, zhvillohet në qytetin e Gjakovës dhe qytetin e Rahovecit. Furnizimi i Liqenit bëhet nga lumi Lumbardhë i Deçanit, përmes kanalit derivues nga Lluka e Epërme deri në Lajthijat, pastaj nëpërmjet kanalit natyral-kanjonit derdhet në liqenin akumulues. Kapaciteti i liqenit është 119.000.000 m³. Kompania ka fabrikën për përpunimin e ujit në fshatin Zhdrellë me kapacitet prodhues deri 600 litra për sekondë.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët tanë, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

¹⁶ Ruzhdi Këpuska ka dhënë dorëheqje në Tetor 2011

¹⁷ Pas dorëheqjes së Kryesuesit, Leonard Shehu është zgjedhur si U.D. i asaj pozite

¹⁸ Agim Gjoshi ka dhënë dorëheqje në Dhjetor 2011

¹⁹ Ismet Ahmeti ka ardhur në pozitën e KE në nëntor 2011

Misioni

Misioni i KRU 'Radoniqi' sh.a. është t'i furnizojë me ujë të pijshëm të gjithë konsumatorët e vetë pa dallim race, religjioni apo kombësie, në rajonin e tyre furnizues, për të siguruar një Kompani financiarisht të vetqëndrueshme dhe afatgjate.

Qasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe etike, e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina, komunat, konsumatorët, etj. Kompania do të zbatojë tarifë të çmimeve që do të vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina, si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave.

Kompania do të shikojë, gjithashtu që ujërat e zeza t'i përpunojë në të ardhmen nëpërmjet një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.

Objektivat për të ardhmen

Kompania HS Radoniqi ka përcaktuar këto objektiva strategjike në periudhën e paraqitjes së Biznes-Planit 2012-2014. Këto objektiva janë të listuara si më poshtë:

- Rritja e ujit të faturuar;
- Rritja e shkallës së arkëtimit në total në 72%;
- Progresi në rritjen e shkallës së arkëtimit në sektorin e amvisërisë, bizneseve dhe institucioneve;
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në 63%;
- Furnizim i vazhdueshëm me ujë të pijes;
- Kontrolli i kualitetit të ujit të pijes në pajtim me instruksionet e lëshuara nga rregulloret;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijes;
- Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit;
- Detektimi i humbjeve;
- Përpilimi dhe realizimi i planeve zhvillimore;
- Forcimi i aktiviteteve në drejtim të institucioneve financiare dhe donatorëve të ndryshëm për sigurimin e mjeteve financiare që do të orientoheshin në drejtim të zvogëlimit të humbjeve, rritjes së kapaciteteve, trajtimit të ujërave të pijes.

Projektet

Disa nga projektet gjatë vitit 2011:

- Objektet ndërtimore, burimi i financimit - mjete vetanake;
- Pajisje elektro-mekanike, burimi i financimit – mjete vetanake;
- Kamionë dhe ekskavatorë, burimi i financimit-donacion nga MZHE-ja;
- Automjete, burimi i financimit, mjete vetanake.

Plani i investimeve bazohet kryesisht nga të ardhurat vetanake dhe buxheti i Qeverisë, megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha, të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të

detajuar. Investimet kapitale për infrastrukturë të re parashikohen të realizohen nga grantet qeveritare dhe donacionet e donatorëve.

Arritjet kryesore pas këtyre investimeve do të jenë:

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë;
- Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;
- Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve telemetrike, mjete të reja pune;
- Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe tek konsumatorët.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU ‘Radoniqi’.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2011 dhe ka përmbajtje të detajuar, duke identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t’i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë 2011, (15 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 10 mbledhje pune. Njësia ka përcjellë punën e efektshmërisë së bordit, sidomos në funksion të funksionalizimit të qeverisjes korporative dhe këtë vlerësim e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	20,377,470	17,598,576
Faturimi i ujit (%)	30	39
Inkasimi i ujit (%)	71	67
Uji i pafaturuar (%)	70	61
Testet e dështuara të ujit (%)	0.1	0.7
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	91	92
Numri i konsumatorëve	27,345	28,018

Tabela 31 - Performanca Operative e KRU Radoniqi

Sipas tabelës, prodhimi i ujit ka ngritje duke e krahasuar me vitin 2010, kështu që me instalimin e ujëmatësit të ri uji matet në mënyrë të saktë dhe kjo matje ka rritur ujin e prodhuar dhe njëkohësisht ka treguar saktë humbjet e ujit ku shihet në tabelën e prezantuar më lartë.


Numri i konsumatorëve ka zbritje me vitin 2010, pasi në vitin 2011 Kompania ka pastrua databazën e konsumatorëve, duke hequr konsumatorët e dyfishtë dhe kioskat.

Proporcioni i konsumatorëve në ujëmatës është i njëjtë, mirëpo departamenti teknik ka filluar instalimin e ujëmatësve të konsumatorët pa ujëmatës.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	2,924	2,729
Shpenzimet	-1,884	-1,829
Fitimi/Humbja operative	1,040	900
Zhvierësimi dhe amortizimi	-1,717	-1,606
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	-677	-706
Paraja në fund të vitit	200	203

Tabela 32 - Performanca Financiare e KRU Radoniq



Grafiku 11 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Radoniq



Grafiku 12 – Paraja ne fund te vitit, KRU Radoniq

Në vitin 2011 të hyrat kanë qenë më të mëdha për 7% se viti paraprak dhe kjo rritje e të hyrave ka ndodhur si rrjedhojë e rritjes së faturimit dhe rritjes së çmimit të ujit.

Kategoria e shpenzimeve ka ngritje kur e krahasojmë me vitin 2010 dhe si vendin më të madh e zë zhvierësimi, gjë e cila pasqyrën e të ardhurave e përfundon me humbje. D.m.th. janë shpenzimet e zhvierësimit ai pozicion i cili Kompaninë e fut në humbje, pasi që Kompani para zhvierësimit operon me fitim.

Humbja në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 është më e vogël për 4.2%.

4.10 KRU Hidromorava

Emri i Kompanisë	KRU Hidromorava, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433937
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Avdyl Hasani (Kryesues) Azem Mujku Xhelal Selmani Elhame Shefkiu
Kryeshefi Ekzekutiv	Myrvete Hoti
Sekretari i Kompanisë	Rozelita Hasani
Drejtori Financiar	Xhelal Shabani
Auditori i Brendshëm	Seniha Hajrullahu

Tabela 33 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidromorava

Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit Hidromorava sh.a., është ndërmarrje publike që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në pjesën juglindore të Kosovës, përkatësisht në komunat e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës.

Kompania posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së saj, të lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina. Prodhimi, shitja e ujit të pijshëm dhe mbledhja e ujërave të zeza janë aktivitetet kryesore të ndërmarrjes. Vlerat kryesore të Kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevantë të sektorit të ujit në Kosovë.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët e Regjionit të Gjilanit sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike, si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

Misioni

Misioni i KRU 'Hidromorava' është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Kompania, po ashtu u ofron konsumatorëve të vet shërbimin e mbledhjes dhe largimit të ujërave të zeza. Kompania angazhohet në zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza dhe eventualisht shikimin e mundësisë së ndërtimit të fabrikës së përpunimit të ujërave të zeza përmes burimeve të jashtme të financimit.

Objektivat për të ardhmen

Objektivat kryesore të kompanisë për periudhën 2013-2016 janë si në vijim:

- Furnizimin me ujë të të gjithë konsumatorëve, përfshirë edhe ata në pikat e larta;
- Përmirësimin e kualitetit të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e IKSHP;
- Arritjen e vetqëndrueshmërisë financiare, duke ngritur shkallën e inkasimit;
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë;
- Adoptimin e politikave tarifore të ZRRUM për arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdoshme;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Zvogëlimin e ujit të pafaturuar dhe zvogëlimin e shpenzimeve për njësi prodhimi.

Projektet

Projektet me rëndësi, të cilat janë duke u zhvilluar në KRU 'Hidromorava' janë:

- Ndërtimi i objektit për administratën e KRU "Hidromorava" sh.a. në Gjilan, financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës – MZHE;
- Ndërtimi dhe planifikimi i oborrit të objektit për administratën e KRU "Hidromorava" sh.a. Gjilan, financuar nga burimet vetanake të kompanisë 'Hidromorava' në Gjilan;
- Ndërtimi i rezervuarit $V=3000$ m³, në 'Kodrën e Dëshmorëve' në Gjilan;
- Ndërtimi i gypit të ujësjellësit në rrugën 'Mulla Idrizi'- Gjilan, financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës – MZHE;
- Ndërtimi i gypit të ujësjellësit në Halim Orana dhe Fehmi Agani – Gjilan, financuar nga Komuna e Gjilanit;
- Ndërtimi i gypit të ujësjellësit në rr. Fehmi Agani – Kamenicë, financuar nga burimet vetanake të kompanisë Hidromorava në Gjilan.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Hidromoravës'.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2011, me përmbajtje të detajuar duke identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas Udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2011, (11 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 6 mbledhje pune. Njësia ka përcjellë punën e Bordit dhe ka konstatuar se Bordi ka qenë në nivel të përgjegjësive dhe ka pasur efekt pozitiv në performancën e kompanisë.

Andaj, edhe NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmerisë së tij në performancën e kompanisë dhe raporti i njëjtë gjendet i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	7,181,811	7,462,760
Faturimi i ujit (%)	41	40
Inkasimi i ujit (%)	78	68
Uji i pafaturuar (%)	59	60
Testet e dështuara të ujit (%)	1.9	1.3
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	81	81
Numri i konsumatorëve	19,110	18,200

Tabela 34 - Performanca Operative e KRU Hidromorava

Nga tabela 34 del se arritjet për vitin 2011 kanë qenë: prodhim i ujit më i vogël për 4% nga viti paraprak, që nga menaxhmenti shpjegohet me arsyet si:

- Kalimi i konsumatorëve nga paushalli në konsumatorë me ujëmatës që ka pakësuar nevojën për harxhim të ujit dhe;
- Qyteti ka pasur ujë të mjaftueshëm dhe s'ka pasur nevojë për prodhim më të madh të ujit.


Gjatë vitit 2011 shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 10% krahasuar me vitin 2010, apo nga 68% në 78%. Në ngritjen e shkallës së arkëtimit ka ndikuar ndërmarrja e disa aktiviteteve të kësaj kompanie për ta ngritur eficiencën e arkëtimit dhe bashkëpunimi me autoritetet lokale.

Performanca Financiare


	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	1,716	1,719
Shpenzimet	-1,113	-1,015
Fitimi/Humbja operative	603	704
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-674	-684
Borxhet e këqija	-281	-406
Fitimi/Humbja financiare	-352	-386
Paraja në fund të vitit	147	89

Tabela 35 - Performanca Financiare e KRU Hidromorava

Tabela 35 tregon se kompania ka zvogëluar humbjet financiare nga viti paraprak për një shumë simbolike, edhe pse është treguar se kompania ka fitim operativ dhe nuk vjen në pikëpyetje vazhdimësia e aktivitetit të saj.



Grafiku 13 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Hidromorava



Grafiku 14 – Paraja ne fund te vitit, KRU Hidromorava

4.11 KRU Hidroregjioni Jugor

Emri i Kompanisë	KRU Hidroregjioni Jugor, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433702
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Naser Bajraktari (Kryesues) Galip Hoda Bujar Hasani Drita Grazhda Sahit Ukaj
Kryeshefi Ekzekutiv	Besim Baraliu
Sekretari i Kompanisë	Ajshe Cikaqi
Drejtori Financiar	Liman Gashi
Auditori i Brendshëm	Ymredin Sylejmani

Tabela 36 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidroregjioni Jugor

Që nga Korriku i vitit 2007 KRU 'Hidroregjioni Jugor' funksionon si shoqëri aksionare. Kjo kompani shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës, duke përfshirë këto komuna:

- Prizren
- Suharekë
- Dragash
- Malishevë dhe
- Mamushë

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve nëntokësore vetanake. Në nivel të kompanisë furnizohen edhe 22 fshatra që janë të kyçura në rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjetës Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

Misioni

Misioni i KRU 'Hidroregjioni Jugor' sh.a. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Objektivat për të ardhmen

- Qëndrueshmëri financiare - (Rritje të mbulimit operativ mbi 1.2, arkëtim mbi 75%);
- Furnizim të rregullt 24 orë – (Zbritje të UPF nën 50%);
- Plotësim të standardeve të shërbimeve në 100%;
- Mbulimi 100% i zonave të shërbimit;
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja;
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkëkohore të trajtimit të ujërave të pijshëm dhe ujërave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave etj.

Projektet

Disa nga projektet e vitit 2011 janë të radhitura më poshtë:

- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Pejë dhe Prizren - Programi "Kosova VI", Faza 2, financuar nga KfW;
- Rehabilitimi i Rrjetit dhe programi zhvillimor i kompanisë, financuar nga USAID;
- Shtimi i kapacitetit të ujërave, përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë, financuar nga komunat e regjionit;
- Infrastruktura e rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i sasisë së ujit të pijes, financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Infrastruktura e rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i sasisë së ujit të pijes, financuar me mjete vetanake.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2011, me përmbajtje të detajuar, duke i identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2011, (9 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 4 mbledhje pune. Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka konstatuar se bordi ka qenë në nivel të përgjegjësive dhe ka pasur efekt pozitiv në performancën e kompanisë. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa

komisione të tjera, të cilat kanë pasur aktivitete që vlen për t'u theksuar. Këto komisione janë: Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Financa dhe Komiteti për Staf dhe Shpërblime.

Andaj, edhe NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së bordit dhe ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	20,439,596	16,122,451
Faturimi i ujit (%)	37	42
Inkasimi i ujit (%)	72	69
Uji i pafaturuar (%)	63	58
Testet e dështuara të ujit (%)	5.3	9
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	82	81
Numri i konsumatorëve	33,490	29,522


Tabela 37 - Performanca Operative e KRU Hidroregjioni Jugor

Pas pajisjeve me ujëmatës zonale, si dhe pas monitorimit të saktë të sasisë së ujit të prodhuar ka rezultuar se sasia e raportuar për vitin 2010 nuk ka qenë plotësisht e matur. Një faktor tjetër që ka rezultuar në këtë ndryshim ka qenë edhe sasia e vogël e ujit të burimeve, sidomos në pjesën e dytë të vitit 2010. E gjithë kjo, bazuar në krahasimin e shënimeve të raportuara rezulton që të kemi rritje të humbjeve të ujit si ujë i pafaturuar, por kemi progres në rritjen e konsumatorëve për 14% në krahasim me vitin paraprak dhe rritje të inkasimit nga faturimi për 3%, apo nga 69% në 72%.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	3,579	2,908
Shpenzimet	-2,428	-2,092
Fitimi/Humbja operative	1,151	816
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,021	-935
Borxhet e këqija	-626	-414
Fitimi/Humbja financiare	-496	-533
Paraja në fund të vitit	8	22

Tabela 38 - Performanca Financiare e KRU Hidroregjioni Jugor



Grafiku 15 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Hidroregjioni Jugor



Grafiku 16 – Paraja ne fund te vitit, KRU Hidroregjioni Jugor

Në tabelën 38 shihet se kompania ka zvogëluar humbjet financiare dhe është në fitim operativ, por për shkak të kostove të zhvlerësimit dhe borxheve të këqija ka përfunduar me humbje vjetore financiare. Rritja e kostove operative vjen edhe për shkak të rritjes së aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes e veçanërisht atyre të kontrollit edhe jashtë orarit të punës, gjithmonë në synim të evidentimit dhe eliminimit të keqpërdorimeve të ujit të pijes. Ekipet e kontrollit kanë kontribuar edhe në arkëtimin e borxheve të akumuluar nga konsumatorët.

Këto aktivitete kanë ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve për derivate, si dhe për mirëmbajtje dhe riparime, sidomos në zonat e reja të shërbimit.

4.12 KRU Hidrodrini

Emri i Kompanisë	KRU Hidrodrini, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433918
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Shkelzen Hyseni (Kryesues) Rexhë Abazi Gjelosh Gojani Elez Hajdaraj
Kryeshefi Ekzekutiv	Agron Tigani
Sekretari i Kompanisë	Vjollca Imami
Drejtori Financiar	Rasim Maloku
Auditori i Brendshëm	Sebahate Hasanaj

Tabela 39 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Hidrodrini

Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim ‘HidroDrini’ është themeluar si shoqëri aksionare në maj të vitit 2007, në përputhje me nenin 35.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/6 mbi Ndërmarrjet Afariste (Rregullorja), për një periudhë të pacaktuar. KRU “Hidrodrini” sh.a është institucion publik i licencuar nga Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina për ofrimin e shërbimeve bazë, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit.

Numri popullatës që KRU “HidroDrini” mbulon me ujë të pijes vlerësohet rreth 185.000 banorë, ndërsa shërbimet e ujërave të zeza 60,000 banorë. Kapaciteti momental prodhues sillet në 2.300.000 m³/mujore.

Qendra e kompanisë është në Pejë. Në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë dhe Junik. Këtu duhet veçuar rastin e Njesisë Operative të Deçanit, ku me vendim të Kuvendit Komunal ata janë shkëputur nga Kompania nga Qershori i vitit 2006; mirëpo me ndryshimin e ligjit mbi NP edhe kjo çështje do të qartësohet.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Misioni

Misioni i përgjithshëm i K.U.R “Hidrodrini” sh.a, është që të sigurojë ujë të pijshëm, të bollshëm dhe pa ndërprerje për të gjithë konsumatorët e saj pa dallim race dhe religjioni. Burimet e ujit duhet të shfrytëzohen racionalisht, për të siguruar furnizimin të pakufizuar dhe sipas standardeve të kërkuara.

Objektivat për të ardhmen

Zvogëlimi i ujit të pafaturuar, që do të arrihet përmes objektivave të poshtëshënuara:

- Përkushtim, angazhim më i madh i punëtorëve në terren dhe matje korrekte të konsumit;

- Riparim të rrjedhjeve sipërfaqësore dhe identifikim të rrjedhjeve nëntokësore në kuadër të menaxhimit të humbjeve;
- Identifikim të shfrytëzuesve të paautorizuar (vjedhja e ujit);
- Rritje e numrit të konsumatorëve, rritje e shkallës së faturimit dhe rritja e shkallës së arkëtimit;
- Ngritja e efikasitetit të stafit;
- Evitimi në kohë dhe eliminimi i menjëhershëm i të gjitha rrjedhjeve vizuale në sistem, si dhe implementimi i zonave DMA, për reduktimin e humbjeve teknike;
- Reduktimi i humbjeve administrative, eliminimi i mangësive në sistemin e inkasimit;
- Implementimi i projekteve donacion nga KfW dhe USAID-it, dhe implementimi i projekt-propozimeve nga KASH-i, si dhe përmbushja e kriterëve për donacione të ardhshme;
- Organizimi më efektiv i kontrollit të brendshëm, për të gjitha departamentet dhe sektorët e Kompanisë, si dhe vlerësimi i performancës çdo tre muaj;

Projektet

Disa nga projektet më me rëndësi gjatë këtij viti janë të radhitura më poshtë:

- Rehabilitimin e gypsjiellësit Pejë-Istog, në ndërtimin e rezervuarëve, në ndërtimin e stacionit të ri të pompimit, financuar nga KfW;
- Rehabilitimin e Sahat-Kullës, projekti për Zatra, financuar nga USAID;
- Rehabilitimi i rrjetit “Istog- Gurakoc”, financuar nga USAID;
- Projekti i zgjerimit për fshatrat Llabjan, Ramun dhe Lutoglavë, financuar nga USAID-IRD;
- Sistemi i ujësjellësit në Vitomiricë, financuar nga Qeveria e Kosovës.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike dhe që kompania i ka përmbushur me sukses.

Raporti vjetor është një raport gjithëpërfshirës për aktivitetet e Ndërmarrjes dhe performancën përgjatë vitit paraprak. Ai duhet të sigurojë Qeverinë dhe grupet e tjera të interesit me vlerësime të ekuilibruara dhe të kuptueshme për performancën e Ndërmarrjes në fund të vitit dhe perspektivat e saj në të ardhmen.

Plani i Biznesit për Ndërmarrjen duhet të përgatitet nga ekipi i menaxhmentit ekzekutiv, bazuar në vizionin dhe objektivat e Ndërmarrjes, që miratohet nga Bordi.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka kompetencë edhe të formoje komisione të tjera, duke u bazuar në nevojat që kompania paraqet. Bordi nuk e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme të formojë ndonjë komision. Gjatë vitit 2011, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 14 mbledhje dhe po aq ka mbajtur edhe Komisioni i Auditimit. Gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndërmarrjes. Edhe pse Kompania nuk ka operim të qëndrueshëm, pasi është në

humbje dhe ka humbje të mëdha të ujit, bordi ishte efektiv në vendimmarrje dhe monitorim të implementimit të Planit të Biznesit.

Njësia ka bërë vlerësim e efektshmërisë së bordit dhe opinionin e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	27,714,364	28,847,678
Faturimi i ujit (%)	30	28
Inkasimi i ujit (%)	62	59
Uji i pafaturuar (%)	70	72
Testet e dështuara të ujit (%)	7.8	8.4
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	86	87
Numri i konsumatorëve	34,719	33,384

Tabela 40 - Performanca Operative e KRU Hidrodrini

Prodhimi i ujit në vitin 2011 ka pasur rënie dhe kjo është si rezultat i investimeve që po realizohen nga ana e Bankës Gjermane dhe USAID. Nga vetë fakti i zëvendësimit të gypave të vjetruar me gypa të rinj është zvogëluar edhe kërkesa për prodhimin e ujit.

Kompania ka një faturim më të madh për 2% nga viti paraprak dhe kjo është si rezultat i angazhimit më të madh të inkasantëve në leximin e ujëmatësve.

Shkalla e arkëtimit është rritur për 3%, progres është shënuar kryesisht tek kategoria e konsumatorëve shtëpiakë, përderisa gjendja me pagesat e faturave ndaj kompanisë është më e keqe të konsumatorët e bizneseve dhe institucioneve.


Numri i konsumatorëve ka pasur një rritje të vogël, krahasuar me vitin paraprak, prej 1335 konsumatorë si rezultat i zgjerimit të rrjetit në disa fshatra.

Humbjet e ujit edhe pse me një ritëm të ngadalshëm, po zvogëlohen për 2% nga vitit në vit. Pritet që pas përfundimit të investimeve të zotuar nga investitorët e jashtëm do të ketë rezultate në zvogëlimin e humbjeve.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	3,067	3,003
Shpenzimet	-1,576	-1,538
Fitimi/Humbja operative	1,491	1,465
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,142	-1,101
Borxhet e këqija	-502	-599
Fitimi/Humbja financiare	-153	-235
Paraja në fund të vitit	417	324

Tabela 41 - Performanca Financiare e KRU Hidrodrini



Grafiku 17 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Hidrodrini



Grafiku 18 – Paraja ne fund te vitit, KRU Hidrodrini

Të ardhurat totale kanë pasur një rritje krahasuar me vitin paraprak dhe kjo si rezultat i angazhimit më të madh të kompanisë.

Kostot nga operimi janë mbajtur në nivelin e planifikuar, por kemi një rritje krahasuar me vitin paraprak.

Zhvlerësimi dhe borxhet e këqija janë shpenzime që varen nga investimet kapitale dhe në qoftë se ka investime kapitale atëherë do të vjen duke u rritur dhe në qoftë se nuk ka investime kapitale ky shpenzim do të jetë më i vogël, sepse baza e llogaritjes së shpenzimit vjen duke u zvogëluar.

Kjo ndërmarrje ka përfunduar vitin me një humbje më të vogël se viti paraprak, si rezultat i rritjes së të hyrave.

4.13 KRU Mitrovica

Emri i Kompanisë	KRU Mitrovica, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433740
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Fehmi Kajtazi (Kryesues) Nusret Gërxhaliu Remzi Sylejmani Haki Maxhuni
Kryeshefi Ekzekutiv	Faruk Hajrizi
Sekretari i Kompanisë	Zejnullah Mehaj
Drejtori Financiar	Muhamet Salihu
Auditori i Brendshëm	Xhevat Bekteshi

Tabela 42 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Mitrovica

Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” sh.a. ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve të ujërave të zeza në pjesën veriore të Kosovës dhe mbulon këto komuna: Mitrovicën, Vushtrinë, Skenderaj dhe Mitrovicën matanë lumit Ibër. Popullata e shërbyer vlerësohet të jetë rreth 170.000 banorë. KRU “Mitrovica” operon edhe me impiantin për trajtimin e ujit në periferi të qytetit, me kapacitet prodhues rreth 520 l/s. Në vitin 2011 është lëshuar edhe impianti i parë i kapacitetit të madh për trajtimin e ujërave të zeza në Skënderaj. Afro 39% nga uji i prodhuar distribuohet matanë Ibrit, pa u inkasuar nga shfrytëzuesit, por që Qeveria e Kosovës e mbulon me subvencione në % të mesatares së inkasuar në regjion.

Vizioni

Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit në Regjionin e Mitrovicës, me çmime sa më të favorshme dhe me ujë cilësorë dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Misioni

Konsumatori në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim: Pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përmbushur këtë “mision” do të bëhet e mundur sigurimi i vetëqëndrueshmërisë, me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe një kompani publike, të qëndrueshme financiarisht dhe të gatshme të ballafaqohet me sfidat.

Objektivat për të ardhmen

Rritja e të hyrave të inkasuara nga faturimi i tërë çka do të arrihet, me një përkrahje më të madhe për shërbimin e inkasimit nga ana e operativës nëpër të gjitha njësitë, si faktor i brendshëm dhe zgjidhja problemit të veriut dhe rasteve sociale, si faktorë të jashtëm. Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për mbulimin e shpenzimeve nga mjetet dhe arkëtimet vetanake.

Projektet

- Ndërtimi i fabrikës së re të ujit në Mitrovicë, me kapacitet prej 700 l/s, i financuar nga Komisioni Evropian;
- Ndërtimi i fabrikës së re të ujit në Vushtrri, me kapacitet 350l/s, i financuar nga Qeveria e Kosovës;
- Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Mitrovicë, i financuar nga Qeveria e Luksemburgut;
- Projekti i finalizuar i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Skenderaj, i financuar nga Komisioni Evropian.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Mitrovica'.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2011, por nuk ka ndonjë përmbajtje të detajuar, pa identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë 2011, (15 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 9 mbledhje pune. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat nuk kane pasur ndonjë aktivitet që vlen për t'u theksuar. Këto komisione janë: Komisioni për Kontrollin e Rrjetit dhe Zvogëlimit të Humbjeve Teknike dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Distribuimit të Ujit.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka konstatuar se bordi është njoftuar për shumë çështje të ndryshme që janë paraqitur në raportet e Auditorit të Jashtëm dhe nuk ka pasur ndonjë vendimmarrje energjike. Andaj, edhe Njësia ka bërë vlerësim e efektshmërisë së punës së tij dhe e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Prodhimi i ujit (m3)	17,770,938	17,667,162
Faturimi i ujit (%)	48	47
Inkasimi i ujit (%)	57	54
Uji i pafaturuar (%)	52	53
Testet e dështuara të ujit (%)	4.3	2.4
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	51	56
Numri i konsumatorëve	24,972	21,797

Tabela 43 - Performanca Operative e KRU Mitrovica

Tabela 43 tregon se në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRU ‘Mitrovica’, sh.a., ka treguar performancë pothuajse të njëjtë, për sa i përket progresit dhe regresit në treguesit kyç.

Ndryshimi në sasinë e prodhuar të ujit ka ardhur si pasojë e intensifikimit të prodhimit dhe mospengesave gjatë procesit të prodhimit dhe shtrirjes së rrjetit të ri të ujësjellësit.

Shkalla e arkëtimit gjatë vitit 2011 ka shënuar progres për 3%, krahasuar me vitin 2010, përderisa faturimi pothuajse ka mbetur në pozitën e njëjtë, me një ndryshim shumë të vogël në përmirësim.


Në humbjen e ujit si ujë i pafaturuar, KRU ‘Mitrovica’ ka shënuar përmirësim prej 1%, e cila kryesisht lidhet me zvogëlimin e ujit të prodhuar, si dhe rritjen në efikasitetin e faturimit të ujit të konsumuar.

Kualiteti i ujit të pijes gjatë vitit 2011, në krahasim me 2010, i cili është furnizuar nga KRU ‘Mitrovica’ lë vend për përmirësim, sidomos tek Njësitë Operative të Vushtrrisë dhe Skenderajt.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	3,775	3,248
Shpenzimet	-1,874	-1,849
Fitimi/Humbja operative	1,901	1,399
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,839	-1,781
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	62	-382
Paraja në fund të vitit	43	257

Tabela 44 - Performanca Financiare e KRU Mitrovica



Grafiku 19 – Fitimi/Humbja Finaniare, KRU Mitrovica



Grafiku 20 – Paraja ne fund te vitit, KRU Mitrovica

Të dhënat nga tabela 44 tregojnë se kompania ka shndërruar humbjen e vitit paraprak në fitim financiar, falë rritjes së të hyrave për 16% nga viti paraprak.

4.14 KU Radoniqi – Dukagjini

Emri i Kompanisë	KU Radoniq-Dukagjini, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70465161
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Canë Delija (Kryesues) Avdullah Kryeziu Artan Nimani Ismet Neziri
Kryeshefi Ekzekutiv	Jahja Kadriu
Sekretari i Kompanisë	Lumnije Këpuska
Drejtori Financiar	Luljeta Morina
Auditori i Brendshëm	Fidan Qufaj

Tabela 45 - Të dhënat e përgjithshme të KU Radoniqi - Dukagjini

KU “Radoniqi – Dukagjini”, sh.a- Gjakovë, është ndërmarrje publike qendrore dhe aksionare e vetme e kësaj kompanie është Republika e Kosovës me 100% të aksioneve.

Kjo kompani është e vendosur në Gjakovë dhe ka tri njësi punuese, të vendosura në fshatin Lugbunar (komuna e Gjakovës), në Xërxë (komuna e Rahovecit) dhe në Prizren.

Sistemi i ujitjes që posedon kjo kompani është i shtrirë në pjesën më pjellore të rrafshit të Dukagjinit. KU “Radoniqi – Dukagjini” sh.a, është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore (si aktivitet primar), në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe të Prizrenit, ndërsa aktivitete sekondare janë: ofrimi i ujit të papërpunuar dhe ndërtimi i rrjetave të ujësjellësve, ujitjes etj. Sasitë e planifikuara të ujit për sezonin e ujitjes varen nga sipërfaqet të cilat janë ujitur, llojin e kulturave, numrin e ujitjes, reshjeve, të cilat kanë dominuar gjatë sezonit vegjetativ.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së Ujitjes Radoniqi-Dukagjini, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

Misioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimtarisë bujqësore, përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

Objektivat për të ardhmen

Qëllimet e kësaj kompanie janë të fokusuara kryesisht në këto fusha:

- Zgjerimin e zonës së shërbimeve;
- Shtimin e numrit të klientëve;
- Angazhim në ngritjen e kualitetit dhe efikasitetit të shërbimeve në vazhdimësi;

- Realizimin e kërkesave të klientëve;
- Angazhimi në ngritjen e shkallës së inkasimit;
- Investimet e nevojshme, qoftë nëpërmjet donacionit, apo të të hyrave vetanake.

Projektet

KU “Radoniqi – Dukagjini” sh.a., gjatë vitit 2011 ka investuar në këto projekte:

- Rehabilitimi i kanalit Marmulle;
- Sanimin e Kaptazhës në G-1 në Lumbardhë të Prizrenit; dhe
- Pjesët e ndërrimit për gypa GRP.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KU Radoniqi-Dukagjini.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë vitit 2011. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të jashtëm dhe Raporti mbi kënaqshmërinë e Konsumatorit.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t’i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës dhe detyrë prioritare e tij është ushtrimi i mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së zyrtarëve të ndërmarrjes. Bordi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 10 takime. Po ashtu, ky organ ka formuar Komisionin për Bashkëpunim, Lobim dhe Performancë.

NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmerisë së punës së Bordit të Drejtorëve, i cili me punën e tij ka ndikuar drejtpërdrejt që kompania vitin 2011 ta përmbyll me fitim financiar nga humbja e vitit të kaluar. Për këtë, vlerësimi i Njësisë mbi efektshmërinë e punës së bordit është i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Uji i furnizuar (m3)	36,926,192	37,299,691
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	5,216	5,012
Faturimi (ha)	567,728	533,476
Inkasimi/Faturimi (%)	56	55


Tabela 46 - Performanca Operative e KU Radoniqi - Dukagjini

Tabela 46 tregon se uji i furnizuar në m3 për ujitje ka pasur rënie për 1%, ndërsa është rrit hapësira e tokës bujqësore për ujitje prej 204ha, sikurse edhe një rritje të % në inkasim nga faturimi.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	887	810
Shpenzimet	-356	-344
Fitimi/Humbja operative	531	466
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-261	-257
Borxhet e këqija	-268	-238
Fitimi/Humbja financiare	2	-29
Paraja në fund të vitit	152	62

Tabela 47 - Performanca Financiare e KU Radoniqi - Dukagjini



Grafiku 21 – Fitimi/Humbja Financiare, KU Radoniqi-Dukagjini



Grafiku 22 – Paraja ne fund te vitit, KU Radoniqi-Dukagjini

Tabela 47 tregon se KRU Radoniqi-Dukagjini vitin 2011 e ka përmbyllur me një progres simbolik, progres ky i cili falë rritjes së të hyrave ka shndërruar humbjen në fitim financiar nga viti paraprak dhe ky është një tregues shpresëdhënës për të ardhmen.

4.15 KU Drini i Bardhë

Emri i Kompanisë	KU Drini i Bardhë, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70465032
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Ali Sefaj (Kryesues) Shkodran Gaxherri Fadil Kabashi Beqir Metaj
Kryeshefi Ekzekutiv	Milazim Shatri
Sekretari i Kompanisë	Gjergj Gjokaj
Drejtori Financiar	Leonora Bajraktari
Auditori i Brendshëm	Brikenda Vokshi

Tabela 48 - Të dhënat e përgjithshme të KU Drini i Bardhë

KU “Drini i Bardhë” është ndërmarrje publike qendrore, ku aksionare e vetme e kësaj kompanie është Republika e Kosovës me 100% të aksioneve. Kjo kompani është e vendosur në Pejë dhe ka tri njësi punuese të vendosura:

- Njësia punuese – Pejë;
- Njësia punuese – Gurrakoc;
- Njësia punuese – Deçan.

KU “Drini i Bardhë”, sh. a. është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore në komunat e Pejës, Istogut dhe Deçanit.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së Drinit të Bardhë – Pejë, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

Misioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimit të prodhimitarisë bujqësore; përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

Objektivat për të ardhmen

Qëllimet e kësaj kompanie janë të fokusuar kryesisht në këto fusha:

- Shërbime të kënaqshme për konsumatorët;
- Stabilitet financiar afatgjatë;
- Mirëmbajtje të sistemit të ujitjes në përputhje me nevojat e konsumatorëve.

Projektet

KU “Drini i Bardhë” sh.a., gjatë vitit 2011 ka investuar në këto projekte:

- Punimi i Kanalit të Kastratëve, i financuar nga Qeveria e Kosovës;
- Punimi i Kanalit të Trubuhovcit, i financuar nga Qeveria e Kosovës;
- Punimi i Kanalit të Pobergjës, i financuar nga Qeveria e Kosovës.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë së Ujitjes Drini i Bardhë-Pejë.

Plani i Biznesit për vitin 2012 është përgatitur me kohë. Aty nuk janë identifikuar synimet qartë, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm, mirëpo ka munguar gatishmëria e Bordit për një vendimmarrje efektive që do të ndikonte në ngritjen e performancës, e cila nuk po përmirësohet.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë, mirëpo ky nuk ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t’i paraqitur të dhënat operative dhe financiare Performanca Operative.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i kësaj ndërmarrje ka mbajtur 9 mbledhje gjatë 2011, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 6 takime gjatë po të njëjtës periudhë. Pothuajse shumica e vendimeve të miratuara nga bordi nuk kanë qenë të frytshme dhe të ekzekutueshme. Nuk është vërejtur efektshmëria e punës së tij në performancën e kompanisë, pasi që e njëjta edhe më tej është në humbje financiare.

Për të gjitha këto Njësia ka vlerësuar efektshmerinë e punës së bordit dhe ky vlerësim është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Uji i furnizuar (m3)	27,126	31,104
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	918	750
Faturimi (%)	100	100
Inkasimi (%)	23	31


Tabela 49 - Performanca Operative e KU Drini i Bardhë

Të dhënat e mësipërme nga tabela nr.49, tregojnë se kompania ka rënie të ujit të furnizuar, edhe pse ka rritje të hapësirës së ujitur për 232ha. Fatkeqësisht konsumatorët-bujqit nuk kryejnë obligimet për këtë shërbim dhe kompania ka arritur të inkasojë vetëm 23% nga faturimi.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	227	170
Shpenzimet	-180	-165
Fitimi/Humbja operative	47	5
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-64	-79
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	-17	-73
Paraja në fund të vitit	16	1

Tabela 50 - Performanca Financiare e KU Drini i Bardhë



Grafiku 23 – Fitimi/Humbja Financiare, KU Drini i Bardhë



Grafiku 24 – Paraja ne fund te vitit, KU Drini i Bardhë

Tabela 50 tregon se kompania, edhe pse ka zvogëluar humbjet financiare për një shumë simbolike, ajo gjendet në krizë financiare, pasi me të hyra e inkasuara prej vetëm 23% nga faturimi kompania nuk mund t'i mbulojë as shpenzimet operative të saj.

4.16 HS Ibër - Lepenci

Emri i Kompanisë	KRU Ibër - Lepenci, sh.a.
Numri i Regjistrimit	70465157
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Nazmi Zenelaj (Kryesues) Murat Meha Faton Gjyshinca Ilmi Ahmeti Bajram Mustafa Gjelosh Vataj
Kryeshefi Ekzekutiv	Hajdar Beqa
Sekretari i Kompanisë	Bajram Jashari
Drejtori Financiar	Sheremet Smakolli
Auditori i Brendshëm	Bahri Hyseni

Tabela 51 - Të dhënat e përgjithshme të KRU Ibër - Lepenc

Është ndërmarrje publike ekonomike, e cila merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë funksional për furnizim me ujë. Kjo kompani ka dy njësi punuese:

- Njësia afariste “Uji dhe centrali elektrik”;
- Njësia afariste “Ujitja”.

Infrastruktura e ndërmarrjes shtrihet në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës në këto komuna: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Kastriot, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Drenas.

HS “Ibër-Lepenc” sh.a. është shoqëri aksionare dhe si ndërmarrje publike hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë funksional për furnizim me ujë industrial, ujitjen e tokave bujqësore, si dhe gjenerimin e energjisë elektrike.

Penda në Ujman – mundëson akumulimin e 375 milionë m³ ujë, sasia e të cilit përdoret për:

- Prodhimin e energjisë elektrike në HC Ujman 2 x 17.5 MW - 82GWh/vit;
- Furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar:
 - KEK-u;
 - Feronikeli.
- Furnizimin e ujësjellësve regjionalë me ujë të papërpunuar:
 - Ujësjellësi regjional i Mitrovicës;
 - Ujësjellësi regjional i Prishtinës (për Drenas).
- Furnizimin e bujqësisë me ujë për ujitje.

Infrastruktura e kësaj ndërmarrjeje:

Objektet e Ndërmarrjes shtrihen në territoret e 8 komunave dhe atë: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas dhe Graçanicë.

Penda Ujman me lartësinë h=107.5 m

Akumulimi Ujman 375 milionë m³

Hydrocentrali Ujman 2 x 17.5 MW

Penda Pridvoricë me lartësinë h=10 m

Akumulimi Pridvoricë 480,000 m³
Kanale kryesore 146 km
Kanali kryesor “Pridvoricë – Obiliq” 50 km kapaciteti 22.2 m³/sec.
Stacione Pompike për ujitje 14
Objekte Ndarëse 4
Rrjeti nëntokësor për ujitje 766 km
Rreth 120 km largpërçues.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të furnizimit me ujë industrial, shërbime të ujitjes së kulturave bujqësore dhe gjenerim të energjisë përmes Hidrocentralit të Ujmanit për konsumatorët e saj, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Hidrosistemit Ibër-Lepenc, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

Misioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit të bujqësisë dhe industrisë me ujë, me qëllim të mundësisë së operimit të termocentraleve, shkretoreve dhe ujësjellësve, ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore për gjëllim gjenerimi me energji elektrike.

Objektivat për të ardhmen

Qëllimi dhe synimi i ndërmarrjes është mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese, modernizimi i sistemit, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve. Qëllimi i kompanisë është edhe rritja e vlerës së aseteve, maksimalizimi i të hyrave me një shfrytëzim sa më efikas të aseteve dhe zgjerimi i shërbimeve të ujitjes së tokave bujqësore.

Objektiva shtesë në të ardhmen për furnizim me ujë industrial nga Penda e UJMAN-it, priten nga:

- KEK – TC “Kosova B+” 380 l/sec plus 380 l/sec;
- Zgjerimi i KUR “Prishtina” fabrika në Shkabaj (dy faza) 700+500 l/sec;
- Zgjerimi i KUR “Mitrovica” me 700 l/sec;
- Ujësjellësi i ri në Vushtrri me 350 l/sec;
- Zgjerimi i sipërfaqeve për ujitje.

Projektet

Gjatë vitit 2011, Njësia Afariste “Ujitja” ka investuar në realizimin e këtyre projekteve:

- Rehabilitimi i kanalit të ujitjes nga dalja e sifonit në Rudine deri në S.P Gllobar;
- Rehabilitimi i S.P. në Pantinë me largpërçues;
- Studimi i mundësive për ndërtimin e mini-hidrocentraleve në pendën Ujman dhe përgjatë kanalit kryesor “Pridvoricë – Obiliq”;
- Shqyrtimi i ripompimit nga penda e Pridvoricës në pendën Ujman;
- Sistemi i kontrollimit dhe monitorimit në Ujman dhe të akumulimit në pendën e Ujmanit;
- Modernizimi i hidrocentralit ekzistues – komandimi, sinjalizimi dhe mundësia e rritjes së gjenerimit të energjisë elektrike;

- Modernizimi i objekteve të ndërmarrjes gjatë kanalit kryesor, komandimi dhe sinjalizimi në distancë;
- Modernizimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes (ndërrimi i gypave të azbestit me gypa të polietilenit etj).

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Ibër-Lepenci.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2011. Aty janë identifikuar synimet si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2011, (13 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse para çdo mbledhje të Bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 11 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komisione janë: Komisioni për Financa, Komisioni për Hulumtime, Zhvillime dhe Investime, Komisioni për Staf dhe Shpërblime, Komisioni për Menaxhim Risku, Komisioni për Bashkëpunim me KEK-un, dhe Komisioni për Investime Kapitale dhe të Ardhura.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së tij, i cili është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Uji i furnizuar (m3)	34,973	33,674
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	1,647	1,271
Energjia e prodhuar dhe e Sshitur (MWh)	75,432	115,460

Tabela 52 - Performanca Operative e KRU Ibër - Lepenc

Tabela 52 tregon se ka rënie të gjenerimit të energjisë, pasi gjenerimi i energjisë elektrike në masë të madhe është i kushtëzuar nga kushtet hidrologjike, niveli i akumulimit në liqen, si dhe nga kërkesat e KEK-ut. Nisur nga kjo, gjenerimi i energjisë elektrike në vitin 2010 ka qenë më i lartë se në vitin 2011 për arsye se në vitin 2010 kanë mbretëruar kushte jashtëzakonisht të mira hidrologjike, gjë që nuk ka ndodhur në vitin 2011.


Furnizimi me ujë industrial është kryesisht i ndikuar nga kërkesat e klientëve për sasinë e ujit dhe ka një rritje prej afro 4% nga viti paraprak.

Megjithëse, ndërmarrja çdo vit e shton numrin e sasive të sipërfaqeve që mund të ujiten, ujitja varet kryesisht nga interesimi i fermerëve për ujitje të tokave bujqësore dhe kështu është rritur sipërfaqja e tokës bujqësore të ujitur në vitin 2011 për 376ha, nga viti paraprak.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	3,810	5,379
Shpenzimet	-3,251	-3,197
Fitimi/Humbja operative	559	2,182
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-4,549	-4,515
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	-3,990	-2,333
Paraja në fund të vitit	1,962	1,785

Tabela 53 - Performanca Financiare e KRU Ibër- Lepenc



Grafiku 25 – Fitimi/Humbja Financiare, KRU Iber-Lepenc



Grafiku 26 – Paraja ne fund te vitit, KRU Iber-Lepenc

Gjithashtu, nga tabela 53 shihet se për shkak të kushteve hidrologjike dhe kërkesave të KEK-ut, viti 2010 ka qenë viti ku janë realizuar të hyrat më të mëdha, në krahasim me vitin 2011, ndërsa kjo kompani, për shkak të vlerës së aseteve, ka edhe shpenzime të mëdha të zhvlerësimit dhe përfundimisht del në humbje financiare, edhe pse është kompani financiarisht e qëndrueshme që nuk subvencionohet nga shteti dhe ishte në fitim operativ, tregues ky që na bën me dije se nuk vjen në pikëpyetje vazhdimësia e funksionimit dhe krijimit të shërbimeve publike.

4.17 KMDK

Emri i Kompanisë	Kompania për Menaxhimin e Deponive, sh.a. (KMDK)
Numri i Regjistrimit	70324870
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Drejtorët e Bordit	Asllan Vitaku (Kryesues) Naim Ferati Bajram Limani Makfirete Osmani Isak Rakovica Eset Rama
Kryeshefi Ekzekutiv	Abdullah Haxhiu ²⁰
Sekretari i Kompanisë	Ilirjana Tahiri
Drejtori Financiar	Liridon Smaka
Auditori i Brendshëm	Kujtim Grajqevci

Tabela 54 - Të dhënat e përgjithshme të KMDK

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK sh.a.) është kompania e vetme si autoritet përgjegjës i legalizuar, e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe plotësisht e regjistruar si shoqëri aksionare, sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare nr. 03/ L-123.

Duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve për deponimin e mbeturinave të ngurta komunale, roli i KMDK sh.a. është esencial në parandalimin e ndotjes së ambientit, keqpërdorimin potencial të këtij shërbimi, si dhe në stimulimin e efikasitetit ekonomik dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët e këtyre shërbimeve. Këtë rol KMDK sh.a. e ushtron duke shfrytëzuar ligjet dhe mekanizmat rregullatorë që i ka në dispozicion.

Kompania për Menaxhimin e Deponive Sanitare të Kosovës shërbimet e veta i ofron në këto qytete qendrore të Kosovës:

- Deponia Sanitare e Prishtinës
- Deponia Sanitare e Podujevës
- Deponia Sanitare e Prizrenit
- Deponia Sanitare e Gjilanit
- Stacionin e transferim në Ferizaj

KMDK ballafaqohet me problem në funksionalitet, nga fakti se nuk ka mundësi të trajtimit të mbeturinave sipas standardeve. Kjo vjen si mungesë e potencialeve financiare për investime në makineri të re, pasi operatorët për grumbullimin e mbeturinave që janë kompani regjionale të mbeturinave me pronësi 100% të komunave, kanë obligime financiare për deponimin e mbeturinave në vlerë prej 2.5 milionë euro.

²⁰ Abdullah Haxhiu ka marrë postin e KE në tetor 2011, pas dorëheqjes së Avni Ramadanit

Vizioni

Shërbime cilësore, të sigurta, dhe efikënte në deponimin e mbeturinave sipas standardeve mjedisore dhe ruajtjes së ambientit për qytetarët e Kosovës.

Misioni

Deponimin e mbeturinave të ngurta komunale në deponitë sanitare regjionale në mënyrë sa më efektive, në pajtim me standardet gjenerale dhe praktikat e mira evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve në deponimin e mbeturinave të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të arsyeshme për grumbulluesit e mbeturinave në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Objektivat për të ardhmen

Çështjet, të cilat do mund ta përcaktojnë të ardhmen e KMDK-së janë:

- Krijimi konditave më të volitshme në vazhdimësi të infrastrukturës së deponive për klientët;
- Përmirësimi i raporteve afariste me KRM-të dhe zgjidhja e çështjes së obligimeve financiare të rregullta mujore të tyre;
- Realizimi i marrëveshjeve për programimin e borxheve të KRM-ve dhe të borxheve të KMDK-së ndaj klientëve, që do të ndikojë në shkallën e inkasimit të të hyrave nga klientët;
- Gatishmëria teknike dhe furnizimi i duhur me makineri të rëndë për nivelin e duhur të operativës nëpër deponi;
- Trajtimi ujërave të ndotura të Deponisë në Mirash;
- Rregullimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të deponive;

Projektet

Në vitin 2011, Kompania për Menaxhimin e Deponive është ndihmuar me mjete financiare nga Buxheti i Kosovës në mbulimin e investimeve në tri projekte kapitale:

- Financimi i makinerisë së rëndë;
- Financimi i infrastrukturës së brendshme të deponive sanitare;
- Trajtimi i ujërave të zeza në deponitë regjionale.

Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë së Menaxhimit të Deponive të Kosovës – KMDMK.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë vitit 2011. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm, mirëpo ka munguar gatishmëria e bordit për përmbushjen e kërkesës ligjore nga neni 29 të Ligjit mbi NP-të, që ka të bëjë me hartimin e raportit të kënaqshmërisë së konsumatorit dhe kjo është marrë parasysh gjatë vlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2011 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare 'Performanca Operative'.

Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera

Konform kompetencave që ka bordi, ai ka mbajtur 14 mbledhje gjatë vitit 2011, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 11 takime gjatë këtij viti. Një pjesë e vendimeve të miratuara nga bordi nuk kanë qenë të frytshme dhe të ekzekutueshme. Nuk është vërejtur efektshmëria e punës së tij në performancën e kompanisë, pasi e njëjta edhe më tej është në humbje financiare. Për të gjitha këto, NJPMNP ka vlerësua efektshmërinë e punës së tij me opinionin, i cili është i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

Performanca Operative

Indikatorët Operativë	2011	2010
Deponimi i mbeturinave (ton)	205,835	192,395
Shkalla e inkasimit (%)	62	57
Kostoja për njësi (euro/ton)	3.76	3.53

Tabela 55 - Performanca Operative e KMDK


Kjo kompani këtë vit ka treguar një nuancë të ngritjes së performancës në disa tregues, duke krahasuar këtë vit me vitin paraprak, pasi shohim që kemi një rritje të sasisë së mbeturinave të deponuara. Po ashtu, kemi edhe një rritje të shkallës së inkasimit për 5% nga viti i kaluar.

Ndërsa, tek kostoja për njësi shohim që kemi një rritje të shpenzimeve operative për ton. Në vitin 2010 kanë qenë 3.53 eu/t, ndërsa në vitin 2011 ato janë rritur në 3.76 eu/t. Kjo ka ardhur si pasojë e sasisë së mbeturinave dhe të masave racionale gjatë operimit me hedhurina.


Performanca Financiare

	2011 (000€)	2010 (000€)
Të hyrat	1,187	1,116
Shpenzimet	-730	-700
Fitimi/Humbja operative	457	416
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,021	-1,010
Borxhet e këqija	-347	-367
Fitimi/Humbja financiare	-911	-961
Paraja në fund të vitit	10,018	112,821

Tabela 56 - Performanca Financiare e KMDK



Grafiku 27 – Fitimi/Humbja Financiare, KMDK



Grafiku 28 – Paraja ne fund te vitit, KMDK

Gjatë vitit 2011 KMDK, sh.a ka pasur ngritje të faturimit për 6,91% në krahasim me vitin 2010, në bazë të ngritjes së sasisë së mbeturinave të deponuara.

Shpenzimet operative kanë pësuar ngritje për vitin 2011 për 4% në krahasim me vitin paraprak 2010, gjë që ka sjellë deri në rezultatin përfundimtar- humbje financiare prej 911 mijë euro, apo një humbje më e vogël për 50 mijë euro nga viti paraprak.

Përmbledhje dhe Rekomandime

Nga të gjitha të dhënat e pasqyruara në këtë raport të performancës së ndërmarrjeve publike të zhvilluara gjatë vitit 2011 dhe duke i krahasuar me periudhën paraprake, mund të raportojmë një avancim në performancë operative, gjithashtu edhe financiare të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Ndër treguesit më të mirë të rezultateve të arritura të përmirësimit të performancës së shërbimeve publike, sipas sektorëve, është progresi në sektorin e energjisë, si për nga indikatorët operativë: prodhimi i thëngjillit, gjenerimi i energjisë, zvogëlimi i humbjeve të energjisë, reduktimi i ndërprerjeve në transimion dhe ngritjes së inkasimit të energjisë. Po ashtu, përparim ka edhe tek performanca financiare me rritjen e fitimit financiar të KEK-ut.

Progres ka edhe në sektorin e ujitjes, duke shtuar sipërfaqen e ujitur të tokave bujqësore për 748 ha, apo rritja e numrit të konsumatorëve për furnizim me ujë të pijshëm për 15.406 konsumatorë të rinj dhe rritje të prodhimit të ujit të pijshëm për 6.1 mil m³.

Shikuar nga prizmi i menaxhimit të parasë publike dhe rregullsisë së proceseve financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe bazuar në Opinionet e Auditorëve të Jashtëm, kemi një progres në krahasim me vitin paraprak, ngase prej shtatëmbëdhjetë pasqyrave financiare të audituara, me vlerësimin më të lartë si të pakualifikuara janë dhjetë NP, ndërsa nuk kemi asnjë pasqyrë financiare të NP-ve me vlerësimin negativ si: opinionin kundërt, apo mohimin e opinionit.

Performanca financiare e NP-ve në vitin 2011, po ashtu kishte progres, ngase dy kompani kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare, dy nga to kanë kthyer humbjet në fitime dhe shtatë nga to kanë zvogëluar humbjet nga viti paraprak.

Natyrisht se krahas rritjes së nevojave për shërbime publike që rrjedhin nga proceset e rritjes së popullsisë dhe rritjes së zhvillimit ekonomik, kërkohet një progres edhe më i madh dhe ka vend për më shumë përparime në zvogëlimin e humbjeve të energjisë, reduktimin e humbjeve të ujit të pijshëm, zvogëlimin e shpenzimeve të borxheve të këqija, rritjen e inkasimit nga shërbimet e kryera, dhe këto sigurisht se do të ndodhin krahas konsolidimit të shtetit, funksionalizimit të gjykatave, investimeve në rrjet të ujësjellësit etj.

Tek funksionalizimi i Qeverisjes Korporative, edhe pse si koncept i ri në Kosovë, ajo ka përparime, pasi të gjitha NP-të i kanë të emëruara Bordet e Drejtorëve, Komisionet e Auditimit dhe punojnë në përputhje me Ligjin mbi NP-të dhe Kodin e Etikës dhe të Qeverisjes Korporative. Por, natyrisht se kërkohet që krahas trajnimeve që do të bëhen për Bordet e Drejtorëve, do të ketë përparime edhe më të mëdha.

Këtë e mundëson edhe miratimi i ndryshim-plotësimit të Ligjit mbi NP-të nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e përgjegjësisë për llogaridhënie, rritje të nivelit të komunikimit me komunat dhe qytetarët, si konsumatorë finalë të shërbimeve publike.

Duke u bazuar në analizat e raportit mbi performancën e Ndërmarrjeve Publike, si dhe sfidave që paraqiten gjatë operimeve të NP-ve me qëllim të krijimit të shërbimeve publike, NJPMNP

rekomandon këto masa që do të ndikonin në përmirësimin dhe avancimin e performancës së NP-ve:

- Avancimi i mëtejshëm i Qeverisjes Korporative në përputhje me parimet e OECD dhe ngritjes së përgjegjësisë për menaxhim me asete publike;
- Trajnimi i Bordeve të drejtoreve të NP qendrore mbi Rolin dhe përgjegjësitë e tyre si vendimmarrës;
- Trajtimi me prioritet nga gjykatat kompetente të lëndëve nga Ndërmarrjet Publike mbi inkasimin e mjeteve për shërbimet publike;
- Investime edhe më tutje në rrjetin e vjetruar të ujësjellësve, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike të ujit- rrjedhjeve të ujit;
- Investime edhe më tutje në infrastrukturën hekurudhore, si përmbushje e standardeve evropiane dhe krijim i mundësive për investitorë të rinj – operatorë të rinj hekurudhorë;
- Hartimi i një strategjie mbi reduktimin e humbjeve të ujit të pijshëm;
- Trajnimi i stafit të NP-ve mbi përmbushjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve;
- Ngritja e komunikimit të NP me institucionet lokale mbi rritjen e kualitetit të shërbimeve publike për qytetarët .

Referencat:

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, (2012). “Raporti Vjetor për vitin 2011 i ANP –Adem Jashari”.

Audit & Conto.(Maj, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur - 31 Dhjetor 2011, KRU Mitrovica”

Audit & Conto.(Mars, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur - 31 Dhjetor 2011, KRU Hidroregjioni – Jugor”

Audit & Conto.(Prill, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur - 31 Dhjetor 2011, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës”

Audit & Conto.(Prill, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur - 31 Dhjetor 2011, KRU Prishtina”

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, (Maj, 2012). “Raporti Vjetor për vitin 2011”

BDO Kosova LLC.(Mars, 2012). “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Operatori i Sistemit te Transmisionit dhe Tregut”

BDO Kosova LLC.(Prill, 2012). “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Ibër-Lepenc”

BDO Kosova LLC.(Prill, 2012). “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës”

BDO Kosova LLC.(Qershor, 2012). “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës”

BU & Partners.(Maj, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur- Drini i Bardhe”

ETIKA.(Prill, 2012). “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Radoniqi-Dukagjini”

Drini i Bardhe. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Grant Thornton LLC. (Prill, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit te Pavarur- Korporata Energjetike e Kosovës”

Ibër-Lepenc. (2012). “Raporti i punës për vitin 2011”

Infrakos. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Kanuni i Auditorit.(Maj, 2012). “Raporti i Auditorëve te Pavarur për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011 – KRU Radoniqi”

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Korporata Energjetike e Kosovës, (2012). “Raporti mbi Performancën për vitin 2011”

KRU Prishtina. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

KRU Mitrovica. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

KRU Hidrodrini. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

KRU Hidroregjioni-Jugor. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

KRU Hidromorava. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

KRU Radoniqi. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës, (2012). “Raport Vjetor 2011”

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Radoniqi-Dukagjini. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Trainkos. (2012). “Raporti Vjetor 2011”

TRENDBIZ.(Prill, 2012). “Raporti Final i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare prej 01 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit 2011 – KRU Hidromorava”

Univerzum Audit. “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për Periudhën 01/09/2011 – 31/12/2011, Infracos”

Univerzum Audit. “Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për Periudhën 01/09/2011 – 31/12/2011, Trainkos”

Univerzum Audit. (Prill, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2011 - KRU Hidrodrini”

Zyra e Regullatorit për Energji, (2012). “Raporti Vjetor 2011”

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina, (Mars, 2012). “Raporti Vjetor 2011”